REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJE
SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Nr.5305 Prot.

Ersekë, më 29.07.2025

# RAPORT PËRFUNDIMTAR

**AUDITIM I KOMBINUAR**

**NË DREJTORINË E PYJEVE, PARQEVE DHE REKREACIONIT**

# PËRMBAJTJA E LËNDËS


I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE ..... 2
II. HYRJE ..... 6
III. METODA E AUDITIMIT ..... 8
IV. GJETJET, KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET PËR ÇDO SISTEM 9
V. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA MË PARË ..... 64

ANEKSI Nr.1 ..... 67
ANEKSI Nr.2 ..... 73

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Nga struktura organizative e Bashkisë Kolonjë e miratuar për vitin 2024 dhe vitin 2025, rezulton se pranë kësaj Bashkie ka funksionuar Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, e cila për nga struktura organizative ka qënë e ndarë në 3 sektorë me një numër prej 14 punonjësish.

2. Në bazë dhe për zbatim të nenit 5, nenit 6 pika "b" ii), v) dhe vi), si dhe pikës 2 të Nenit 9 të Ligjit Nr. 114/2015, "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" (*i ndryshuar*), "Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", miratuar me Urdhërin Nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, Planit Vjetor të miratuar nga Titullari i Institucionit me Vendimin Nr. 36, datë 16.10.2024 për vitin 2025 si dhe Urdhërit të Shërbimit Nr. 2900 Prot., datë 17.06.2025 të Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm, Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kolonjë, ushtroi auditimin në Drejtorinë e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.

3. *Objekti i Auditimit:* Vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit me aktet ligjore në fuqi dhe vlerësimi nëse përmbushja e objektivave të veprimtarisë në këtë drejtori po realizohet nëpërmjet proceseve efektive dhe përdorimit të fondeve me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.

4. *Qëllimi i Auditimit:* Informimi i menaxhimit mbi punën e kryer nga Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, raportimi i gjetjeve dhe konkluzioneve, dhënia e opinioneve për funksionimin e sistemve të kontrollit të brendshëm, dhënia e rekomandimeve për të ndihmuar Drejtorinë e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit në përmirësimin e veprimtarisë së saj në arritjen e objektivave.

5. *Periudha e Auditimit:* 01.01.2024-31.05.2025.

6. *Përmbledhje e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve kryesore:*

   Gjatë ushtrimit të këtij auditimi, Njësia e Auditit të Brendshëm ka konstatuar një numër të konsiderueshëm parregullsish sistematike të cilat, në gjykimin e grupit auditues, dëshmojnë për mosmirëfunksionim të ushtrimit të kontrollit nga ana e menaxhimit të lartë drejtues të kësaj drejtorie. Aspektet kryesore të këtyre parregullsive janë si më poshtë vijon:

7. **A. Planifikimit dhe Menaxhimit të Burimeve**

   1. Dokumente që provojnë kualifikimet dhe identitetin:
      - Mungojnë dëshmitë e njohjes së gjuhës së huaj për 9 punonjës.
      - Mungon Vërtetimi i Njësimit me Origjinalin për diplomën dhe listën e notave për 6 punonjës.
      - Mungon fotokopja e ID-së për 3 punonjës.

- Mungon certifikata personale dhe familjare për 2 punonjës.

2. Dokumente për përmbajtjen standarde të dosjeve:
   - Mungon Jetëshkrimi në formatin Europass për 1 punonjës.
   - Mungojnë Fleta Prezantuese dhe Inventari i Dosjes në disa raste.
3. Dokumente që lidhen me marrëdhënien e punës:
   - Mungojnë Kontratat Individuale të Punës për pozicione të rregulluara nga Kodi i Punës.
   - Mungojnë Përshkrimet e punës për pozicionet respektive.
   - Mungojnë vlerësimet e performancës 6-mujore dhe vjetore.
4. Dokumentacion për procedura të brendshme:
   - Mungon dokumentacioni mbi procedurën e ngritjes në detyrë për një punonjës.
5. Mungesë dokumentacioni bazë organizativ dhe planifikues:
   - Mungon Rregullorja e Brendshme - nuk ka përkufizim të strukturës dhe funksioneve të brendshme.
   - Mungojnë Planet Mujore të Punës dhe Raportet e Analizës së Punës.
   - Mungojnë plan-projekte vjetore dhe plane operacionale për pyje dhe kullota.
   - Mungon Strategjia për kullotat/livadhet dhe Plani i Masave kundër zjarreve.
6. Mungesë planeve teknike të menaxhimit mjedisor:
   - Mungojnë Plani për mbrojtjen e biodiversitetit dhe Planet e Mbarështimit për pyje/kullota.
7. Mungesë zbatimi procedurash për administrimin e pasurive:
   - Nuk është realizuar procedura për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të amortizuara.

8. **B. Sistemi i menaxhimit të pyjeve.**

- Mungojnë evidencat përkatëse mbi inspektimin pyjor;
- Mungojnë evidencat përkatëse mbi trajtimin drusor dhe furnizimin me dru zjarri;
- Mungojnë evidencat mbi marrjn e masave për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me monitorimin e mirëmbajtjes dhe funksionimit të infrastrukturës lidhur me fondin pyjor;
- Mungojnë evidencat mbi marrjn e masave për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me mbikëqyrjen e punës për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e erozionit, rrëshqitjeve dhe ortekëve;
- Mungojnë evidencat mbi marrjn e masave për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me mbështetjen e pronarëve/përdoruesve të fondit pyjor përmes trajnimeve si dhe zhvillimin e kërkimeve shkencore në të.

9. **C. Sistemi i menaxhimit të kullotave.**

- Nuk është hartuar studimi përkatës mbi sipërfaqet pyjore/kullosore për përdorim pas miratimit në parim nga Kryetari i Bashkisë, sipas kritereve ligjore.
- Nuk janë hartuar raportet tekniko-ekonomike në përputhje me Shtojcën nr. 1 të Udhëzimit nr. 1, datë 9.6.2016.

- Nuk janë plotësuar formularët nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5 sipas formatit dhe parashikimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 9.6.2016.
- Mungojnë evidencat mbi zbatimin e procedurës për vlerësimin e ofertave dhe shpalljen e subjektit fitues.
- Për vitin 2024 janë lidhur 56 kontrata, por mungojnë në dosjen e auditimit kontratat nr. 32, nr. 37 dhe nr. 49.
- Për lidhjen e kontratave të qirasë janë marrë 56 vendime, por mungon vendimi nr. 32.
- Për vendimet nr. 37 dhe nr. 49 mungojnë kontratat respektive.
- Mungojnë procesverbalet për marrjen në dorëzim të sipërfaqeve sipas kontratave të qirasë.
- Mungojnë evidencat mbi kontratat e lidhura në vitin 2025.
- Mungojnë kërkesat e subjekteve të interesuara për marrjen e kullotave me qira.
- Mungon dokumentacioni shoqërues i kërkesave për marrje me qira (certifikata veterinare, vërtetimi i njësisë administrative për vendbanimin dhe numrin e bagëtive, si dhe lista e objekteve ndihmëse për kullotjen).
- Nuk janë respektuar afatet ligjore për shqyrtimin e kërkesave dhe lidhjen e kontratave.
- Nga ana e qiradhënësit nuk është bërë asnjë sondazh gjatë periudhës së kullotjes.
- Mungojnë procesverbalet e mbledhjeve të strukturës përkatëse për shqyrtimin e kërkesave.
- Mungojnë evidencat mbi përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor, të cilat duhet të dërgohen çdo muaj në Ministrinë e Mjedisit.
- Mungojnë evidencat mbi informimin me shkrim të bashkisë nga subjektet qiramarrëse mbi ecurinë e veprimtarisë dhe problematikat e hasura.

10. **D. Sistemi i gjuetisë.**

- Mungesa e evidencave mbi përmbushjen e detyrimeve për monitorimin dhe administrimin e gjuetisë.

11. **E. Sistemi i menaxhimit kadastral.**

- Mungesa e evidencave mbi përmbushjen e detyrimeve për sistemin e menaxhimit kadastral të fondit pyjor.

12. Për të gjitha rastet e konstatura më sipër, grupi i auditimit ka dhënë rekomandimet përkatëse, të cilat janë pasqyruar edhe në Ankesin Nr. 1.

13. *Opinion mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm*

Nga auditimi i ushtruar pranë Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, u konstatua se, funksionimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm rezulton i pjesshëm dhe jo efektiv. Janë evidentuar mangësi të theksuara në dokumentacionin standard të dosjeve të personelit, mungesë e planeve strategjike dhe operacionale, si dhe boshllëqe në proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore, çka reflekton dobësi në nivelin e kontrollit administrativ. Në fushën e menaxhimit të fondit pyjor dhe kullosor, mungojnë evidencat mbi inspektimet, trajtimet drusore, monitorimin e infrastrukturës, raportet tekniko-ekonomike, formularët standardë, si dhe një sërë kontratash dhe vendimesh përkatëse, duke treguar për mosrespektim të plotë të procedurave ligjore dhe mungesë të kontrollit të brendshëm mbi përdorimin dhe administrimin e pasurisë publike. Po ashtu, është konstatuar mungesa e evidencave mbi administrimin e gjuetisë dhe funksionimin e sistemit kadastral, gjë që përbën rrezik për përdorim të pakontrolluar dhe pasqyrim jo real të aseteve. Në këto rrethana, sistemi i kontrollit të brendshëm nuk garanton në nivelin e duhur ligjshmëri, transparencë dhe llogaridhënie, duke e bërë të domosdoshme forcimin e mekanizmave të brendshëm të kontrollit, standardizimin e dokumentacionit dhe zbatimin e plotë të procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi. Për sa më sipër, grupi i auditimit gjykon se menaxhimi i lartë drejtues në këtë drejtori është joefektiv.

## II. HYRJE

14. Në Drejtorinë e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit u realizua auditim i kombinuar që përfshiu sistemin e burimeve njerëzore, sistemin e menaxhimit të pyjeve, sistemin e menaxhimit të kullotave, sistemin e gjuetisë, sistemin e menaxhimit kadastral dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.

15. *Auditimi u krye bazuar në dispozitat ligjore të mëposhtme:*

- Ligjit Nr. 114/*2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"(i ndryshuar)*;
- Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" (*i ndryshuar*);
- Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" *(i ndryshuar)*;
- Ligji Nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" *(i ndryshuar)*;
- Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" (*i ndryshuar)*;
- Ligji Nr. 1954/2003 "Për Arkivat" *(i ndryshuar)*;
- Ligji Nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Repulikës së Shqipërisë" *(i ndryshuar)*;
- Ligji Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" (*i ndryshuar*);
- Manuali Për Auditimin e Brendshëm të Ministrisë së Financave;
- - Ligji "Për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor kombëtar në Republikën e Shqipërisë"
- - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 21.6.2006, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", të ndryshuar;
- - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 22, datë 9.1.2008, "Për përcaktimin e procedurave dhe kritëreve të administrimit të pyllit komunal";
- - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 394, datë 21.6.2006, "Për kritëret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së Materialit drusor e prodhimeve të tjera, pyjore e jo-pyjore";
- - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 19.12.2007, "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje";
- - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1374, datë 10.10.2008, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqën për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor"
- - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1354, datë 10.10.2008, "Për kritëret për caktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar në fondin kullosor";
- - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1353, datë 10.10.2008, Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit tëknik, kritëret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqës dhe të vëllimit të fondit pyjor";

- - Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr.3, datë 22.6.2007, "Mbi procedurën e miratimit të planëve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave komunale";
- - Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr. 4, datë 12.9.2008, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor";
- - Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr.5, datë 13.9.2006, "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave e nën-ngastrave për shfrytëzim, të damkosjes së drurëve, të prerjes e asortimit, të transportit e stivosjes së Materialit drusor në anë të rrugës.
- Vendime relevante të Këshillit Bashkiak Kolonjë etj.
- Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar).
- Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"
- Ligji Nr.57/2020 "Për Pyjet" ( i ndryshuar).
- Udhëzim Nr.2 , datë 20.7.2016 " Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari"
- VKM Nr. 171, datë 18.03.2022 "Për ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe Regjistrin e Fondit Kullosor, përcaktimin e strukturës, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dheënave në nivel vendor, rajonal e qëndror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve".

16. Auditimi u krye në zbatim të Planit Vjetor të Auditimit të miratuar nga Titullari i Institucionit me me Vendimin Nr. 36, datë 16.10.2024 për vitin 2025 si dhe Programit të Angazhim Auditimit Nr. 2960 Prot., datë 19.06.2025.

17. Për fillimin e misionit, grupi i auditimit kërkoi të zhvillohej takimin prezantues në ambientet e Bashkisë Kolonjë. Njësia e audituar nuk shfaqi interes për zhvillimin e këtij takimi dhe as nuk konfirmoi pjesëmarrjen e saj.

18. Misioni i auditimit u krye nga grupi i auditimit i përbërë nga:
Znj. Laura Skënderas - audituese, njëkohësisht përgjegjëse e grupit;
Z. Arnold Fetallari - auditues.

19. Afati i auditimit: Nga data 30.06.2025 deri më datën 28.08.2025

20. Titullari i Institucionit, u vu në djeni mbi ecurinë e angazhimit, problematikat e hasura, gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit.

## III. METODA E AUDITIMIT

21. Në misionin e auditimit janë përdorur metoda dhe teknika si:

*1. **Rishikimi i dokumentacionit*** përmes verifikimit nëse Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit i zbaton ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse, shqyrtimi i regjistrave dhe dosjeve duke kontrolluar kontratat, faturat, raportet financiare dhe dokumentat zyrtare për përputhshmëri.
*2. **Intervistat me punonjësit*** për të marrë informacion mbi proceset dhe praktikat e ndjekura.
*3. **Analiza e të dhënave*** për të kontrolluar performancën e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit në periudha të ndryshme për të identifikuar devijime të mundshme.
4. ***Testimi i mostrave (Sampling)*** duke zgjedhur dokumenta, transaksione apo vendime dhe akte administrative të tjera për të vlerësuar përputhshmërinë ligjore.
*5. **Metoda e ndjekjes (Follow-up)*** përmes kontrollit të masave korrigjuese të marra pas auditimeve të mëparshme për të siguruar se janë adresuar problemet e identifikuara.

22. U plotësuan pyetësorët për mjedisin e kontrollit të brendshëm, funksionimin organizativ të Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit etj. U vlerësua hartimi dhe zbatimi i plan-veprimit mbi rekomandimet e dhëna në auditimin e mëparshëm.

23. Grupi i auditimit gjykoi se ky dokumentacion është i mjaftueshëm për të mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.

24. **IV. GJETJET, KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET PËR ÇDO SISTEM**

Sipas strukturës së miratuar për vitin 2024 dhe vitin 2025, Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit ka qenë e përbërë nga 3 sektorë dhe kanë funksionuar në zbatimin të Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" *(i ndryshuar)* si dhe akteve të tjera në bazë dhe për zbatim të tij dhe Rregullores së Brendshme të Bashkisë Kolonjë.

25. **4.1 SISTEMI I PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE**

**1. Titulli i Gjetjes:** Në dosjet e personelit, mungon dëshmia e gjuhës së huaj për punonjësit: Petro Kristo, Fatjon Kasko, Aurel Ramollari, Edrion Ajazi, Rushan Nazarko, Islam Liço, Eno Butka, Suljot Orhanasi, Ervin Çuka.

| **Nr. i Gjetjes 1** | |
|---|---|
| **Subjekti i Auditua r** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.<br>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", lidhja Nr. 1 dhe lidhja Nr. 2. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Në dosjet e personelit mungon dëshmia e njohjes së gjuhës së huaj për punonjësit: Petro Kristo, Fatjon Kasko, Aurel Ramollari, Edrion Ajazi, Rushan Nazarko, Islam Liço, Eno Butka, Suljot Orhanasi dhe Ervin Çuka.<br>**Kriteri:** Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", specifikisht:<br>• Lidhja Nr. 1-model standard i fletës së inventarit,<br>• Lidhja Nr. 2-model standard i fletës prezantuese të dosjes së punonjësit.<br>**Ndikimi/Efekti:** Kjo mungesë përbën një mangësi në dokumentacionin zyrtar të personelit dhe mund të shkaktojë probleme gjatë auditimeve apo gjatë vlerësimit të përmbushjes së kritereve për pozicionin e punës.<br>**Shkaku:** Mungesa e dokumentacionit mund të jetë pasojë e mosdorëzimit nga punonjësit në momentin e rekrutimit ose e mungesës së ndjekjes së rregullt nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. |

| | |
|---|---|
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I ulët |
| **Konkluzioni** | Mospasja e dëshmive të gjuhës së huaj në dosjet e punonjësve tregon nevojën për rregullim dhe përditësim të menjëhershëm të dokumentacionit, në përputhje me standardet ligjore. |
| **Rekomandimi** | Të dorëzohen dëshmitë për njohjen e gjuhës së huaj nga ana e punonjësve Petro Kristo, Fatjon Kasko, Aurel Ramollari, Edrion Ajazi, Rushan Nazarko, Islam Liço, Eno Butka, Suljot Orhanasi dhe Ervin Çuka. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**2. Titulli i Gjetjes:** Në dosjet e personelit, mungon Vërtetimi i Njësimit me Origjinalin për Diplomën Bachelor/ Master dhe listën e notave, respektivisht për punonjësit: Ervin Çuka, Suljot Orhanasi, Kristaq Koroveshi, Rushan Nazarko, Edrion Ajazi, Petro Kristo.

| **Nr. i Gjetjes 2** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.<br>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", lidhja Nr. 1 dhe lidhja Nr. 2. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Në dosjet e personelit mungon Vërtetimi i Njësimit me Origjinalin për Diplomën Bachelor/Master dhe listën e notave, për punonjësit: Ervin Çuka, Suljot Orhanasi, Kristaq Koroveshi, Rushan Nazarko, Edrion Ajazi, Petro Kristo.<br>**Kriteri:** Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", specifikisht:<br>• Lidhja Nr. 1-model standard i fletës së inventarit, |

| | |
|---|---|
| | • Lidhja Nr. 2-model standard i fletës prezantuese të dosjes së punonjësit<br><br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtyre vërtetimeve cënon vlefshmërinë ligjore të dokumentacionit të dorëzuar si dhe krijon boshllëqe në dosjen personale të punonjësve. Kjo situatë mund të sjellë pasoja gjatë auditimeve si edhe të ngrejë dyshime mbi plotësimin e kritereve të kualifikimit për pozicionin e punës.<br>**Shkaku:** Mund të jetë pasojë e mosdërgimit të dokumentacionit të plotë nga punonjësit në momentin e punësimit, mungesës së kontrollit nga burimet njerëzore, ose mosndërgjegjësimit mbi rëndësinë e vërtetimit zyrtar të kopjeve të dokumenteve. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Dosjet e personelit nuk janë në përputhje të plotë me kërkesat e dokumentacionit të nevojshëm për arsimimin, ndaj kërkohet ndërhyrje e menjëhershme për të siguruar vërtetësinë dhe përputhshmërinë e tyre me origjinalin. |
| **Rekomandimi** | Të dorëzohen Vërtetimet e Njësimit me Origjinalin për diplomat dhe listat e notave brenda një afati të përcaktuar. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**3. Titulli i Gjetjes**: Në dosjen e personelit, mungon dokumentacioni mbi procedurën e ndjekur për ngritje në detyrë të punonjësit Petro Kristo.

| **Nr. i Gjetjes 3** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.<br>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të |

| | |
|---|---|
| | Regjistrit Qendror të Personelit", lidhja Nr. 1 dhe lidhja Nr. 2. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Në dosjen e personelit mungon dokumentacioni që vërteton procedurën e ndjekur për ngritjen në detyrë të punonjësit Petro Kristo.<br>**Kriteri:** Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", specifikisht:<br>• Lidhja Nr. 1-model standard i fletës së inventarit,<br>• Lidhja Nr. 2-model standard i fletës prezantuese të dosjes së punonjësit<br>**Ndikimi/Efekti:** Kjo mungesë krijon paqartësi dhe cenon transparencën e procesit të ngritjes në detyrë, duke rrezikuar shkeljen e parimeve të meritës dhe ligjshmërisë.<br>**Shkaku:** Mund të jetë pasojë e mospasjes së dokumentacionit të plotë në momentin e arkivimit ose mungesës së protokollimit të vendimit. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Ngritja në detyrë nuk është e dokumentuar zyrtarisht në dosje, kjo përbën një mangësi serioze në administrimin e burimeve njerëzore dhe kërkon korrigjim të menjëhershëm për të garantuar ligjshmërinë e veprimit. |
| **Rekomandimi** | Kërkohet urgjentisht nga struktura përkatëse dorëzimi i të gjithë dokumentacionit që lidhet me procedurën e ngritjes në detyrë për punonjësin Petro Kristo në mënyrë që dosja të jetë e plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

<u>**4. Titulli i Gjetjes**: Në dosjet e personelit, mungon fotokopja e dokumentit të identitetit për punonjësit: Edrion Ajazi, Suljot Orhanasi, Rushan Nazarko.</u>

| | |
|---|---|
| | **Nr. i Gjetjes 4** |
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |

| | |
|---|---|
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.<br>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", lidhja Nr. 1 dhe lidhja Nr. 2. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Në dosjet e personelit mungon fotokopja e dokumentit të identitetit për punonjësit: Edrion Ajazi, Suljot Orhanasi dhe Rushan Nazarko.<br>**Kriteri:** Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", specifikisht:<br>• Lidhja Nr. 1-model standard i fletës së inventarit,<br>• Lidhja Nr. 2-model standard i fletës prezantuese të dosjes së punonjësit<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtij dokumenti pengon verifikimin bazë të të dhënave personale të punonjësve dhe cenon përmbushjen e standardeve të dokumentacionit zyrtar.<br>**Shkaku:** Kjo mangësi mund të jetë rezultat i mosdorëzimit të dokumentit nga punonjësit gjatë pranimit në punë ose neglizhencës në përditësimin e dosjes nga sektori përgjegjës. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I mesëm. |
| **Konkluzioni** | Dosjet e personelit janë të paplota dhe nuk përmbajnë një nga dokumentet themelore për identifikimin zyrtar të punonjësve, gjë që kërkon korrigjim të menjëhershëm. |
| **Rekomandimi** | Të njoftohen punonjësit përkatës që të dorëzojnë fotokopjen e dokumentit të identitetit brenda një afati të përcaktuar, në mënyrë që të plotësohen dosjet dhe të sigurohet përputhshmëri me kërkesat administrative dhe ligjore. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

5. **Titulli i Gjetjes:** Në dosjet e personelit, mungon Jetëshkrimi në formatin Europass për punonjësit; Rushan Nazarko.

| Nr. i Gjetjes 5 | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.<br>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", lidhja Nr. 1 dhe lidhja Nr. 2. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Në dosjen e personelit mungon Jetëshkrimi në formatin Europass për punonjësin Rushan Nazarko.<br>**Kriteri:** Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", specifikisht:<br>• Lidhja Nr. 1-model standard i fletës së inventarit,<br>• Lidhja Nr. 2-model standard i fletës prezantuese të dosjes së punonjësit<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtij dokumenti pengon vlerësimin e plotë dhe të strukturuar të përvojës profesionale, kualifikimeve dhe kompetencave të punonjësit, duke cenuar standardet e dokumentacionit të personelit dhe transparencën në procesin e punësimit.<br>**Shkaku:** Jetëshkrimi mund të mos jetë dorëzuar nga punonjësi gjatë aplikimit ose pranimit në punë, ose mund të jetë lënë jashtë dosjes për shkak të mosndjekjes së rregullt nga drejtoria përgjegjëse për burimet njerëzore. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I mesëm. |
| **Konkluzioni** | Dosja e punonjësit është e paplotë dhe nuk përmban një nga dokumentet bazë që reflekton profilin profesional dhe akademik të punonjësit. |
| **Rekomandimi** | Të kërkohet nga punonjësi Rushan Nazarko që të dorëzojë Jetëshkrimin në formatin Europass, në mënyrë që të plotësohet dokumentacioni dhe të garantohet përputhshmëria me standardet institucionale të administrimit të personelit. |

| | |
|---|---|
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**6. Titulli i Gjetjes**: Në dosjet e personelit, mungon Certifikata Personale dhe Familjare për punonjësit: Islam Liço, Eno Butka.

| **Nr. i Gjetjes 6** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.<br>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", lidhja Nr. 1 dhe lidhja Nr. 2 |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Në dosjet e personelit mungon Certifikata Personale dhe Familjare për punonjësit Islam Liço dhe Eno Butka.<br>**Kriteri:** Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit".<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtij dokumenti krijon boshllëqe në dosjen personale, duke penguar përmbushjen e plotë të kërkesave administrative dhe ligjore për evidencën e të dhënave personale dhe familjare të punonjësve.<br>**Shkaku:** Kjo mungesë mund të jetë pasojë e mosdorëzimit të dokumentit nga punonjësit gjatë pranimit në punë ose moskontrollimit të rregullt të dosjeve nga drejtoria përgjegjëse për burimet njerëzore |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I mesëm. |
| **Konkluzioni** | Dosjet e punonjësve përkatës janë të paplota dhe duhet të përditësohen për të garantuar përmbushjen e standardeve të nevojshme administrative. |

| | |
|---|---|
| **Rekomandimi** | Të njoftohen punonjësit Islam Liço dhe Eno Butka që të dorëzojnë Certifikatën Personale dhe Familjare për të plotësuar dosjet dhe për të garantuar përputhshmërinë me rregulloret institucionale. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**7. Titulli i Gjetjes:** Në disa prej dosjeve të personelit, mungon Fleta Prezantuese dhe Inventari i Dosjes.

| **Nr. i Gjetjes 7** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.<br>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", lidhja Nr. 1 dhe lidhja Nr. 2. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Në disa prej dosjeve të personelit mungon Fleta Prezantuese dhe Inventari i Dosjes, të cilat përbëjnë elementë të domosdoshëm tëdosjes së personelit.<br>**Kriteri:** Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", specifikisht:<br>• Lidhja Nr. 1-model standard i fletës së inventarit,<br>• Lidhja Nr. 2-model standard i fletës prezantuese të dosjes së punonjësit<br>**Ndikimi/Efekti**: Mungesa e këtyre dokumenteve vështirëson organizimin, identifikimin dhe kontrollin e përmbajtjes së dosjeve.<br>**Shkaku:** Kjo situatë mund të jetë rezultat i mosplotësimit të plotë të dokumentacionit në momentin e përgatitjes së dosjes ose mungesës së ndjekjes së një strukture standarde të arkivimit nga drejtoria e burimeve njerëzore. |

| | |
|---|---|
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I ulët. |
| **Konkluzioni** | Mospasja e Fletës Prezantuese dhe Inventarit të Dosjes përbën një mangësi në standardizimin dhe administrimin e dokumentacionit të personelit. |
| **Rekomandimi** | Të ndërmerret një proces verifikimi për të identifikuar të gjitha dosjet ku mungojnë këto dokumente dhe të plotësohen me Fletën Prezantuese dhe Inventarin përkatës, duke ndjekur një model të unifikuar për të gjitha dosjet e personelit. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

<u>8. Titulli i Gjetjes: Në dosjet e personelit, mungojnë Kontratat Individuale të Punës për pozicionet që rregullohen nga Kodi i Punës.</u>

| **Nr. i Gjetjes 8** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.<br>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", lidhja Nr. 1 dhe lidhja Nr. 2 |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Në dosjet e personelit mungojnë Kontratat e Punës për pozicionet e punës, ushtrimi i të cilave rregullohet nga Kodi i Punës.<br>**Kriteri:** Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", specifikisht:<br>• Lidhja Nr. 1-model standard i fletës së inventarit,<br>• Lidhja Nr. 2-model standard i fletës prezantuese të dosjes së punonjësit<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e kontratave të punës krijon pasiguri ligjore për |

| | |
|---|---|
| | marrëdhëniet e punës, cenon të drejtat dhe detyrimet e punonjësve dhe punëdhënësit, dhe rrit rrezikun e mosrespektimit të normave të Kodit të Punës. **Shkaku:** Kjo mund të jetë për shkak të mosdokumentimit të saktë gjatë procesit të rekrutimit, mungesës së përditësimit të dosjeve, ose neglizhencës në administrimin e dokumentacionit nga drejtoria përgjegjëse për burimet njerëzore. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Mungesa e kontratave të punës në dosjet e personelit është një shkelje serioze e kërkesave ligjore dhe administrative që duhet të zgjidhet urgjentisht për të siguruar ligjshmërinë e marrëdhënieve të punës. |
| **Rekomandimi** | Të plotësohen dosjet e personelit me Kontratat Individuale të Punës për pozicionet që rregullohen nga Kodi i Punës. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**9. Titulli i Gjetjes:** Në dosjet e personelit, mungojnë përshkrimet e punës për secilin pozicion pune.

| **Nr. i Gjetjes 9** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.<br>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", lidhja Nr. 1 dhe lidhja Nr. 2 |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Në dosjet e personelit mungojnë përshkrimet e punës për secilin pozicion pune.<br>**Kriteri:** Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për |

| | |
|---|---|
| | përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit".<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e përshkrimeve të punës vështirëson ndarjen mbi detyrat, përgjegjësitë dhe kërkesat e çdo pozicioni, duke penguar një menaxhim efektiv të burimeve njerëzore dhe vlerësimin korrekt të performancës së punonjësve. Kjo mund të çojë gjithashtu në keqkuptime ose mosrespektim të detyrave të punës apo përplasje mes tyre.<br>**Shkaku:** Arsyeja mund të jetë mungesa e një procesi të standardizuar për dokumentimin e pozicioneve të punës ose mosndjekja e procedurave të brendshme për hartimin dhe ruajtjen e përshkrimeve të detajuara të punës. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Mungesa e përshkrimeve të punës në dosjet e personelit përbën një boshllëk në administrimin e burimeve njerëzore dhe duhet të adresohen sa më shpejt për të përmirësuar strukturën organizative dhe proceset e punës. |
| **Rekomandimi** | Të hartohen dhe përditësohen përshkrimet e detajuara të punës për të gjitha pozicionet në përputhje me standardet institucionale, dhe të integrohen në dosjet e personelit për të siguruar qartësi dhe transparencë në funksionet dhe përgjegjësitë e çdo punonjësi. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**10. Titulli i Gjetjes:** Në dosjet e personelit, mungojnë vlerësimet e performancës, 6 mujore dhe vjetore për punonjësit.

| **Nr. i Gjetjes 10** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.<br>• Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. |

| | |
|---|---|
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Vendim Nr. 109, datë 26.02.2014 "Për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë" (ndryshuar me VKM Nr. 252, datë 30.03.2016), kreu II, pika 1, gërma a dhe pika 2. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Në dosjet e personelit mungojnë vlerësimet e performancës 6 mujore dhe vjetore për punonjësit.<br>**Kriteri:** Vendim Nr. 109, datë 26.02.2014 "Për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë" (ndryshuar me VKM Nr. 252, datë 30.03.2016), kreu II, pika 1, gërma a dhe pika 2.<br>**Ndikimi/Efekti:** Kjo mungesë ndikon negativisht në menaxhimin e burimeve njerëzore, pasi pamundëson monitorimin dhe zhvillimin e performancës së punonjësve, si dhe pamundëson bazën për vendime të drejtë në avancime, trajnime apo masa disiplinore.<br>**Shkaku:** Mungesa e këtyre vlerësimeve mund të jetë për shkak të moszbatimit të rregullt të procedurave të vlerësimit nga drejtuesit ose mungesës së një sistemi të mirëorganizuar për regjistrimin dhe arkivimin e tyre. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Dosjet e personelit janë të paplota dhe nuk përmbushin kriteret e nevojshme për menaxhimin e performancës, gjë kjo që kërkon ndërhyrje urgjente për përmirësimin e procesit të vlerësimit të punës së punonjësve. |
| **Rekomandimi** | Të plotësohen dosjet e personelit me vlerësimet e rezultateve 6 mujore dhe vjetore për të gjithë punonjësit dhe duke plotësuar dosjet ekzistuese me mungesat e identifikuara. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë dhe në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**11. Titulli i Gjetjes:** Në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Kolonjë ka përplasje mes detyrave të punonjësve të Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.

| **Nr. i Gjetjes 11** | |
|---|---|
| **Subjekti i** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |

| | |
|---|---|
| **Auditua**r | |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit<br>• Drejtoria Juridike dhe e prokurimeve Publike. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji 129/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore". |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Kolonjë janë konstatuar përplasje mes detyrave të punonjësve të Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.<br>**Kriteri:** Ligji 129/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024.<br>**Ndikimi/Efekti:** Kjo përplasje krijon paqartësi në ndarjen e përgjegjësive, mbivendosje funksionesh dhe mundësi për konflikt kompetencash mes punonjësve, duke ndikuar negativisht në eficiencën dhe organizimin e punës së drejtorisë.<br>**Shkaku:** Mund të jetë pasojë e një përpilimi jo të qartë ose jo të harmonizuar të detyrave në rregullore, pa u bërë një analizë funksionale e strukturës dhe rolit të secilit pozicion. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Rregullorja aktuale përmban mospërputhje që dëmtojnë funksionimin efektiv të Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit dhe kërkohet rishikim për të shmangur mbivendosjen e kompetencave. |
| **Rekomandimi** | Të ndërmerret një proces rishikimi dhe harmonizimi i Rregullores së Brendshme në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse, për të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e çdo pozicioni, në funksion të një ndarje të saktë të punës dhe rritjes së efikasitetit. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | Është paraqitur observacion. |

**12. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim dhe i publikuar, rezulton se mungon Rregullorja e Brendshme e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.

| Nr. i Gjetjes 12 | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji 129/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore". |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim dhe i publikuar, rezulton se mungon Rregullorja e Brendshme e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, hartimi dhe publikimi i së cilës përbën detyrim ligjor.<br>**Kriteri:** Ligji 129/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtij dokumenti pengon përcaktimin e qartë të strukturës, funksioneve dhe detyrave të brendshme të drejtorisë, duke krijuar paqartësi në menaxhim, shpërndarjen e përgjegjësive dhe vlerësimin e punës së stafit.<br>**Shkaku:** Mund të jetë pasojë e mosmiratimit të një rregulloreje specifike për këtë drejtori ose mungesës së arkivimit dhe përfshirjes së saj në dokumentacionin zyrtar të dorëzuar për auditim. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Mosqenia në dispozicion e Rregullores së Brendshme të Drejtorisë përbën një mangësi serioze që ndikon në qartësinë organizative dhe funksionimin efektiv të saj. |
| **Rekomandimi** | Të hartohet dhe miratohet në mënyrë urgjente Rregullorja e Brendshme e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, sipas parimeve të ndarjes së qartë të funksioneve dhe përgjegjësive dhe të sigurohet arkivimi i saj në dosjet zyrtare dhe publikimi në përputhje me rregullat e transparencës. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | Është paraqitur observacion. |

**13. Titulli i Gjetjes:** Nuk është ngritur Komisioni për Nxjerrjen Jashtë Përdorimit të Aktiveve të konstatura si të tilla nga Komisioni i Inventarizimit.

| **Nr. i Gjetjes 13** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit.<br>• Drejtoria Ekonomike, Financës, Buxhetit. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" (*i ndryshuar*) i Ministrisë së Financave. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Me Urdhërin Nr.666, datë11.12.2024 'Për ngritjen e Komisioneve të Inventarizimit dhe Inventarizimin e Aktiveve", janë ngritur komisionet e inventarizimit dhe është bërë inventarizimi i aktiveve të Bashkisë Kolonjë dhe Njësive Administrative si dhe Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit. Nga inventarizimi i kryer është evidentuar se ekzistojnë aktive jashtë përdorimit, por për këto nuk është ngritur komisioni përkatës për vlerësimin dhe nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore.<br>**Kriteri:** Paragrafët 107, 108 dhe 109 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" (i ndryshuar) i Ministrisë së Financave.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e ngritjes së komisionit për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve ka sjellë mosreflektim të saktë të vlerës reale të aktiveve në evidencat financiare dhe kontabël të Bashkisë Kolonjë si dhe rrezik për mbartjen e informacionit të pasaktë mbi pasuritë në përdorim, duke ndikuar në planifikimin dhe mirëmbajtjen e aseteve<br>**Shkaku:** Mungesë e organizimit të brendshëm dhe ndjekjes së procedurave standarde për administrimin e aseteve |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I mesëm. |
| **Konkluzioni** | Nuk janë ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm për administrimin e duhur të aseteve, duke mos ngritur komision për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të evidentuara si të tilla gjatë inventarizimit. Kjo situatë përbën një mangësi në menaxhimin financiar dhe administrativ të pasurisë publike. |
| **Rekomandimi** | Të ngrihet komision për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike të Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, në zbatim të paragrafëve 107, 108 dhe 109 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" (*i ndryshuar*) i Ministrisë së Financave si dhe të përditësohen |

| | |
|---|---|
| | regjistrat kontabël pas vlerësimit dhe të reflektohet situata reale e aseteve. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Brenda vitit 2025. |
| **Statusi i rekomandimit** | Është paraqitur observacion. |

<u>**14. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungojnë Planet Mujore të Punës për periudhën objekt auditimi.</u>

| **Nr. i Gjetjes 14** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungojnë Planet Mujore të Punës për periudhën objekt auditimi. 2024-2025.<br>**Kriteri:** Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e Planeve Mujore të Punës cenon transparencën dhe kontrollin mbi ecurinë e punës, pengon ndjekjen dhe vlerësimin e realizimit të detyrave si dhe rrit rrezikun për devijime nga objektivat e planifikuara.<br>**Shkaku:** Mungesa e hartimit dhe miratimit të planeve mujore mund të jetë rezultat i mosrespektimit të kërkesave të brendshme për planifikim, mungesës së përgjegjshmërisë nga strukturat përkatëse apo mungesës së një mekanizmi mbikëqyrës efektiv. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Mungesa e Planeve Mujore të Punës për periudhën objekt auditimi tregon për një mangësi në procesin e planifikimit dhe ndjekjes së punës brenda drejtorisë.Kjo cenon efektivitetin e menaxhimit dhe monitorimit të aktivitetit, si dhe ndikon |

| | |
|---|---|
| | negativisht në arritjen e objektivave të vendosura. |
| **Rekomandimi** | Drejtoria duhet të hartojë dhe të miratojë në mënyrë të rregullt Planet Mujore të Punës, duke siguruar ruajtjen dhe dokumentimin e tyre për çdo periudhë. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë dhe në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**15. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungojnë evidencat mbi analizën mujore të punës dhe raportet periodike për realizimin e detyrave.

| **Nr. i Gjetjes 15** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungojnë evidencat mbi analizën mujore të punës dhe raportet periodike për realizimin e detyrave për periudhën objekt auditimi.<br>**Kriteri:** Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtyre evidencave pengon monitorimin e vazhdueshëm të realizimit të detyrave, ul transparencën dhe përgjegjshmërinë institucionale si dhe rrit rrezikun për mosplotësimin në kohë të objektivave të planifikuara.<br>**Shkaku:** Mungesa e një procedure të mirëpërcaktuar për hartimin dhe ruajtjen e analizave mujore dhe raporteve periodike si dhe mungesa e mbikëqyrjes efektive nga strukturat përgjegjëse. |

| | |
|---|---|
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka zbatuar praktika të rregullta të raportimit dhe vetëvlerësimit të punës, kjo tregon mangësi në sistemin e brendshëm të kontrollit dhe në procesin e monitorimit të performancës. |
| **Rekomandimi** | Drejtoria duhet të hartojë dhe zbatojë një procedurë të qartë për realizimin dhe dokumentimin e analizave mujore dhe raporteve periodike të punës, duke siguruar ruajtjen e tyre dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme përmes strukturave përkatëse të kontrollit të brendshëm. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë dhe në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | Është paraqitur observacion. |

<u>**16. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungon Plani për mbrojtjen e biodiversitetit.</u>

| **Nr. i Gjetjes 16** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungon Plani për mbrojtjen e biodiversitetit për periudhën objekt auditimi.<br>**Kriteri:** Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtij plani cenon menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, rrit rrezikun për dëmtimin e habitateve natyrore dhe humbjen e specieve të mbrojtura, si dhe vështirëson përmbushjen e angazhimeve ligjore dhe ndërkombëtare për ruajtjen e biodiversitetit.<br>**Shkaku:** Mungesa e një procesi të organizuar planifikimi dhe koordinimi ndërinstitucional, si dhe mungesa e prioritizimit të çështjeve mjedisore në |

| | |
|---|---|
| | politikat vendore/ndërsektoriale. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Institucioni nuk ka hartuar dhe miratuar një plan të dedikuar për mbrojtjen e biodiversitetit, duke lënë boshllëqe të rëndësishme në politikat e menaxhimit mjedisor dhe duke rrezikuar degradimin e pasurive natyrore. |
| **Rekomandimi** | Drejtoria të hartojë, miratojë dhe zbatojë një Plan të detajuar për mbrojtjen e biodiversitetit, në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare, duke përfshirë masa konkrete, afate kohore dhe mekanizma monitorimi. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | Është paraqitur observacion. |

**17. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungon Plan-Projekti Vjetor (2024 dhe 2025) për nevojat financiare të operacioneve dhe masave teknike për t'u kryer në sipërfaqe dhe fondin pyjor/ kullosor.

| **Nr. i Gjetjes 17** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungon Plan-Projekti Vjetor për vitet 2024 dhe 2025, për nevojat financiare të operacioneve dhe masave teknike që duhet të kryhen në sipërfaqe dhe fondin pyjor/kullosor.<br>**Kriteri:** Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e Plan-Projekteve Vjetore pengon parashikimin e nevojave buxhetore dhe operacionale, vështirëson realizimin në kohë të |

| | |
|---|---|
| | ndërhyrjeve teknike në fondin pyjor dhe kullosor si dhe rrit rrezikun për shfrytëzim të pakontrolluar ose degradim të këtyre pasurive natyrore.<br>**Shkaku:** Mungesë e organizimit të brendshëm dhe planifikimit afatshkurtër nga strukturat përgjegjëse për menaxhimin e fondit pyjor/kullosor; gjithashtu mungesë koordinimi me strukturat financiare për përfshirjen e nevojave teknike në buxhetin vjetor. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka përmbushur detyrimin për hartimin e Plan-Projekteve Vjetore për menaxhimin dhe financimin e masave teknike në fondin pyjor dhe kullosor, duke krijuar boshllëqe në planifikimin buxhetor dhe operacional për vitet 2024 dhe 2025. |
| **Rekomandimi** | Drejtoria të hartojë dhe miratojë në mënyrë periodike Plan-Projektet Vjetore për operacionet dhe masat teknike në fondin pyjor dhe kullosor, duke përfshirë një vlerësim të qartë të nevojave financiare dhe duke i integruar ato në procesin e planifikimit buxhetor të institucionit. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | Është paraqitur observacion. |

**18. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungojnë Planet e Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave.

| **Nr. i Gjetjes 18** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024. |

| | |
|---|---|
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungojnë Planet e Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave për zonën/fondin objekt auditimi.<br>**Kriteri:** Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e Planeve të Mbarështimit e bën të pamundur menaxhimin e qëndrueshëm dhe të planifikuar të burimeve natyrore, rrit rrezikun e shfrytëzimit të pakontrolluar, degradimit të fondit pyjor dhe kullosor, si dhe vështirëson mbrojtjen e biodiversitetit dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore.<br>**Shkaku:** Shkaku lidhet me mungesën e prioritizimit të këtij procesi nga njësia përgjegjëse, mungesën e fondeve të dedikuara dhe/ose mungesën e bashkëpunimit me institucionet e specializuara për hartimin e planeve. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Mungesa e Planeve të Mbarështimit tregon për dobësi në menaxhimin afatmesëm dhe afatgjatë të fondit pyjor dhe kullosor, si dhe për mungesë të mekanizmave planifikues të mirëstrukturuar nga ana e institucionit përgjegjës. |
| **Rekomandimi** | Rekomandohet që institucioni të ndërmarrë menjëherë hapat për hartimin dhe miratimin e Planeve të Mbarështimit për pyjet dhe kullotat, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke bashkëpunuar me specialistë të fushës dhe duke siguruar fondet e nevojshme për zbatimin e tyre. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | Është paraqitur observacion. |

**19. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungojnë planet operacionale për aktivitetet vjetore në pyje dhe kullota.

| **Nr. i Gjetjes 19** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |

| | |
|---|---|
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungojnë planet operacionale për aktivitetet vjetore në pyje dhe kullota për periudhën objekt auditimi.<br>**Kriteri:** Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e planeve operacionale pengon realizimin e ndërhyrjeve teknike dhe masave të nevojshme për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e fondit pyjor dhe kullosor. Kjo sjell rrezikun e keqmenaxhimit të burimeve natyrore, mungesës së kontrollit mbi shfrytëzimin dhe degradimit të mjedisit.<br>**Shkaku:** Shkaku lidhet me mungesën e një procesi të rregullt planifikimi operativ nga struktura përgjegjëse, mungesën e koordinimit ndërinstitucional dhe mungesën e burimeve njerëzore dhe financiare të dedikuara për këtë funksion. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I mesëm. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka hartuar dhe miratuar planet operacionale vjetore për aktivitetet në fondin pyjor dhe kullosor, kjo tregon për mungesë të planifikimit teknik dhe për dobësi në menaxhimin efektiv të pasurive natyrore. |
| **Rekomandimi** | Drejtoria të hartojë dhe të miratojë planet operacionale vjetore për aktivitetet në pyje dhe kullota, duke përfshirë objektiva të qarta, masa teknike, afate kohore dhe vlerësim financiar. Këto plane duhet të shërbejnë si bazë për zbatimin, monitorimin dhe kontrollin efektiv të aktiviteteve në terren. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | Është paraqitur observacion. |

**20. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungon Strategjia dhe Plani i Veprimit për kullotat dhe livadhet.

| **Nr. i Gjetjes 20** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |

| | |
|---|---|
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungon Strategjia dhe Plani i Veprimit për kullotat dhe livadhet për periudhën objekt auditimi.<br>**Kriteri:** Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e një strategjie dhe plani veprimi e bën të pamundur menaxhimin e qëndrueshëm të kullotave dhe livadheve, çon në shfrytëzim të pakontrolluar, degradim të tokave dhe humbje të biodiversitetit.<br>**Shkaku:** Mungesa lidhet me neglizhencën institucionale në përfshirjen e kullotave dhe livadheve në politikat zhvillimore, mungesën e kapaciteteve teknike për hartimin e strategjive, si dhe me mungesën e bashkëpunimit me aktorët lokalë dhe përdoruesit e drejtpërdrejtë të këtyre pasurive. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka hartuar një dokument strategjik dhe plan veprimi për menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kullotave dhe livadheve, gjë që përbën një mangësi serioze në kuadrin e planifikimit afatmesëm dhe të mbrojtjes së burimeve natyrore. |
| **Rekomandimi** | Drejtoria dhe të miratojë një Strategji dhe Plan Veprimi për menaxhimin e kullotave dhe livadheve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet mjedisore. Ky dokument duhet të përfshijë objektiva të matëshme, masa konkrete, burime financiare dhe mekanizma monitorimi për zbatimin në terren. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | Është paraqitur observacion. |

**21. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungon Plani i Masave për mbrojtjen e fondit kullosor nga zjarri.

| Nr. i Gjetjes 21 | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024. |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i administruar për auditim, rezulton se mungon Plani i Masave për mbrojtjen e fondit kullosor nga zjarri për periudhën objekt auditimi.<br>**Kriteri:** Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kolonjë 2024.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtij plani rrit rrezikun e përhapjes së zjarreve në fondin kullosor, duke shkaktuar dëmtime të mëdha në sipërfaqet kullosore, humbje të pasurive natyrore, si dhe dëm ekonomik për komunitetet lokale dhe përdoruesit e këtyre zonave.<br>**Shkaku:** Mungesa e një procesi të organizuar për hartimin dhe miratimin e planit, si dhe mungesa e koordinimit ndërinstitucional dhe burimeve të dedikuara për parandalimin e zjarreve në fondin kullosor. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka përmbushur detyrimin për hartimin e Planit të Masave për mbrojtjen nga zjarri, duke rrezikuar mbrojtjen efektive të fondit kullosor dhe duke u ekspozuar ndaj dëmtimeve të mundshme nga zjarret. |
| **Rekomandimi** | Drejtoria të hartojë, miratojë dhe zbatojë një Plan të detajuar të Masave për mbrojtjen e fondit kullosor nga zjarri, duke përfshirë masa parandaluese, koordinim me aktorët relevantë dhe mekanizma monitorimi efektiv. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

26. ***Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:***

*Nga kontrolli i ushtruar për këtë sistem, evidentohen mangësi sistematike dhe të thella që lidhen me mënyrën se si strukturohet, menaxhohet dhe monitorohet kjo njësi. Në thelb, auditimi zbulon jo vetëm mungesa të rënda në dokumentacionin e dosjeve të personelit, por edhe boshllëqe serioze në planifikimin institucional dhe zbatimin e detyrimeve ligjore. Mungesa e dokumenteve bazë si rregulloret e brendshme, planet mujore të punës, strategjitë për biodiversitetin apo planet për fondin pyjor dhe kullosor tregon qartë se institucioni nuk funksionon sipas një kuadri të qartë menaxhimi, duke e lënë hapësirën për vendimmarrje të paqarta, veprimtari të pakontrolluara dhe përgjegjësi të mbivendosura. Një aspekt veçanërisht shqetësues është mungesa e një sistemi të strukturuar të kontrollit të brendshëm dhe moszbatimi i cikleve të rregullta të raportimit dhe vlerësimit, që janë thelbësore për menaxhimin e mirëqeverisur të pasurive natyrore.*

*Për më tepër, raporti thekson rrezikun që sjell mungesa e vlerësimeve të performancës dhe përshkrimeve të detajuara të pozicioneve të punës, çka ndikon drejtpërdrejt në eficiencën dhe llogaridhënien e stafit. Pa një ndarje të qartë rolesh dhe një sistem meritokratik të avancimit në karrierë, struktura rrezikon të bjerë në praktikën e informalitetit dhe keqmenaxhimit. Në nivel strategjik, mungesa e planeve të veprimit për pyjet, kullotat dhe parqet sjell pasoja të drejtpërdrejta në mbarëvajtjen e politikave për ruajtjen e pasurive natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm territorial.*

*Nga analiza e detyrave funksionale të përmbushura nga kjo Drejtori si dhe mungesa e një ndarje të qartë të detyrave dhe kompetencave mos kësaj drejtorie dhe Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit rural, ka përplasje, mbivedosje dhe paqartësi në drejtim të detyrave funksionale dhe operacionale të kryera nga secila.*

*Në përfundim, ky auditim jo vetëm që evidenton dobësi të natyrës administrative, por ngre alarmin për mungesën e kapaciteteve strukturore dhe funksionale që e pengojnë institucionin të përmbushë misionin e tij. Nevojitet një ndërhyrje gjithëpërfshirëse dhe e strukturuar që përfshin hartimin e dokumenteve bazë, forcimin e burimeve njerëzore dhe zbatimin rigoroz të kontrolleve të brendshme në përputhje me ligjin dhe praktikat e mira të administrimit publik.*

27. **4.2 SISTEMI I MENAXHIMIT TË PYJEVE**

**22. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se mungojnë evidencat përkatëse mbi inspektimin pyjor.

| **Nr. i Gjetjes 22** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit. |

| | |
|---|---|
| **nga gjetja** | |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr.57/2020 "Për Pyjet" (*i ndryshuar*). |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar u konstatua se mungojnë evidencat përkatëse që vërtetojnë kryerjen e inspektimit pyjor.<br>**Kriteri:** Ligji Nr.57/2020 "Për Pyjet" ( i ndryshuar), neni 17, pika 1, gërma " g".<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtyre evidencave sjell rrezikun e mosrespektimit të kuadrit ligjor, përdorimit joefikas të burimeve natyrore, mungesës së transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale, si dhe krijimit të mundësive për abuzime apo dëmtim të pasurisë pyjore.<br>**Shkaku:** Ky problem ka ardhur si pasojë e mungesës së një sistemi të plotë monitorimi dhe arkivimi të dokumentacionit përkatës, si dhe dobësive në procesin e kontrollit të brendshëm dhe ndjekjes së procedurave standarde për dokumentimin e inspektimeve. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka siguruar dokumentacionin e nevojshëm për të provuar inspektimin dhe trajtimin drusor, gjë që përbën mangësi të dukshme në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në zbatimin e legjislacionit për administrimin e pyjeve. |
| **Rekomandimi** | Rekomandohet që Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit të marrë masa për garantimin e respektimit të kuadrit ligjor në fushën e administrimit dhe mbrojtjes së pyjeve, duke siguruar dokumentimin dhe arkivimin e plotë të të gjitha inspektimeve pyjore, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.57/2020 "Për Pyjet" (*i ndryshuar*) si dhe akteve nënligjore në fuqi. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë dhe në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**23. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se mungojnë evidencat përkatëse mbi trajtimin drusor dhe furnizimit me dru zjarri.

| **Nr. i Gjetjes 23** |
|---|

| Subjekti i Audituar | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
|---|---|
| Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit. |
| Përmbledhja e bazës ligjore | • Ligji Nr.57/2020 "Për Pyjet" (*i ndryshuar*). |
| Përshkrimi i gjetjes | **Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar rezulton se mungojnë evidencat përkatëse që vërtetojnë kryerjen e trajtimit drusor dhe furnizimit me dru zjarri.<br>**Kriteri:** Ligji Nr.57/2020 "Për Pyjet" ( i ndryshuar) , Kreu V.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtyre evidencave rrit rrezikun e mosrespektimit të kuadrit ligjor për administrimin e pyjeve dhe furnizimin me dru zjarri, përdorimit joefikas të burimeve drusore, mungesës së transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale, si dhe mundësisë për abuzime apo dëmtim të pasurisë pyjore dhe shkelje të procedurave të furnizimit të qytetarëve.<br>**Shkaku:** Ky problem ka ardhur si pasojë e mungesës së një sistemi të plotë monitorimi dhe arkivimi të dokumentacionit përkatës, si dhe dobësive në procesin e kontrollit të brendshëm dhe ndjekjes së procedurave standarde për trajtimin drusor dhe furnizimin me dru zjarri. |
| Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët) | I lartë. |
| Konkluzioni | Drejtoria nuk ka siguruar dokumentacionin e nevojshëm për të provuar kryerjen e trajtimit drusor dhe furnizimin me dru zjarri, gjë që përbën mangësi të dukshme në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në zbatimin e legjislacionit në fuqi. |
| Rekomandimi | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit të marrë masa për garantimin e respektimit të kuadrit ligjor në fushën e administrimit dhe mbrojtjes së pyjeve, duke siguruar dokumentimin dhe arkivimin e plotë të trajtimeve drusore dhe furnizimeve me dru zjarri, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.57/2020 "Për Pyjet" (*i ndryshuar*), Kreu V dhe akteve nënligjore në fuqi. |
| Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit | Menjëherë dhe në vijimësi. |
| Statusi i rekomandimit | I pranuar. |

**24.Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, mungojnë evidencat mbi marrjn e masave për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me monitorimin e mirëmbajtjes dhe funksionimit të infrastrukturës lidhur me fondin pyjor.

| **Nr. i Gjetjes 24** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr.57/2020 "Për Pyjet" (*i ndryshuar*). |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar rezulton se mungojnë evidencat që tregojnë se janë marrë masat për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me monitorimin e mirëmbajtjes dhe funksionimit të infrastrukturës që lidhet me fondin pyjor.<br>**Kriteri:** Ligji Nr.57/2020 "Për Pyjet" ( i ndryshuar), neni 17, pika 1, gërma "g".<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtyre evidencave rrit rrezikun e mosrespektimit të kuadrit ligjor, funksionimit joefikas të infrastrukturës pyjore dhe përdorimit të papërshtatshëm të burimeve natyrore. Gjithashtu, kjo situatë ul transparencën dhe përgjegjshmërinë institucionale dhe krijon mundësi për abuzime ose dëmtime të pasurisë pyjore dhe të infrastrukturës së lidhur me fondin pyjor.<br>**Shkaku:** Ky problem ka ardhur si pasojë e mungesës së një sistemi të plotë monitorimi dhe arkivimi të dokumentacionit përkatës, si dhe dobësive në procesin e kontrollit të brendshëm dhe ndjekjes së procedurave standarde për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës pyjore. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka siguruar dokumentacionin e nevojshëm që vërteton marrjen e masave për zbatimin e detyrimeve ligjore mbi monitorimin e mirëmbajtjes dhe funksionimit të infrastrukturës pyjore, gjë që përbën një mangësi të dukshme në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në zbatimin e legjislacionit në fuqi. |
| **Rekomandimi** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit të sigurojë dokumentimin dhe arkivimin e plotë të masave të ndërmarra për monitorimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore, në përputhje me ligjin dhe akteve nënligjore në fuqi. |

| | |
|---|---|
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**25. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, mungojnë evidencat mbi marrjn e masave për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me mbikëqyrjen e punës për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e erozionit, rrëshkitjeve dhe ortekëve.

| **Nr. i Gjetjes 25** | |
|---|---|
| **Subjekti i Auditur** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr.57/2020 "Për Pyjet" (*i ndryshuar*). |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar rezulton se mungojnë evidencat që tregojnë se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me mbikëqyrjen e punës për përmirësimin e zonave të gërryera dhe për luftimin e erozionit, rrëshqitjeve dhe ortekëve.<br>**Kriteri:** Ligji Nr.57/2020 "Për Pyjet" ( i ndryshuar), neni 17, pika 1, gërma "dh".<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtyre evidencave rrit rrezikun e mosrespektimit të kuadrit ligjor, përkeqësimit të gjendjes së zonave të gërryera, shkatërrimit të infrastrukturës pyjore dhe rritjes së rrezikut nga fenomene natyrore si erozioni, rrëshqitjet dhe ortekët. Gjithashtu, kjo situatë ul transparencën dhe përgjegjshmërinë institucionale dhe mund të krijojë mundësi për keqmenaxhim të burimeve pyjore.<br>**Shkaku:** Ky problem ka ardhur si pasojë e mungesës së një sistemi të plotë monitorimi dhe arkivimi të dokumentacionit përkatës, si dhe dobësive në procesin e kontrollit të brendshëm dhe ndjekjes së procedurave standarde për mbikëqyrjen e punës dhe zbatimin e masave për përmirësimin e zonave të gërryera dhe parandalimin e fenomeneve erosive. |

| | |
|---|---|
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I mesëm |
| **Konkluzioni** | Institucioni nuk ka siguruar dokumentacionin e nevojshëm që vërteton marrjen e masave për mbikëqyrjen e punës dhe zbatimin e detyrimeve ligjore në lidhje me përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e erozionit, rrëshqitjeve dhe ortekëve, gjë që përbën një mangësi të dukshme në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në zbatimin e legjislacionit në fuqi |
| **Rekomandimi** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit të sigurojë dokumentimin dhe arkivimin e plotë të masave të ndërmarra për mbikëqyrjen e punës dhe zbatimin e masave për përmirësimin e zonave të gërryera, si dhe për parandalimin dhe menaxhimin e erozionit, rrëshkitjeve dhe ortekëve, në përputhje me ligji dhe aktet nënligjore në fuqi. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

<u>**26.Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, mungojnë evidencat mbi marrjn e masave për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me mbështetjen e pronarëve/përdoruesve të fondit pyjor përmes trajnimeve si dhe zhvillimin e kërkimeve shkencore në të.</u>

| **Nr. i Gjetjes 26** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr.57/2020 "Për Pyjet" (*i ndryshuar*). |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar rezulton se mungojnë evidencat që tregojnë se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me mbështetjen e pronarëve dhe përdoruesve të fondit pyjor përmes trajnimeve, si dhe për zhvillimin e kërkimeve shkencore në këtë fushë.<br>**Kriteri:** Ligji Nr.57/2020 "Për Pyjet" (*i ndryshuar*), neni 17, pika 1, gërma "e" dhe "ë". |

| | |
|---|---|
| | **Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtyre evidencave rrit rrezikun e mosrespektimit të kuadrit ligjor, kufizon mundësitë e pronarëve dhe përdoruesve të fondit pyjor për të përmirësuar praktikat e menaxhimit, si dhe pengon zhvillimin e kërkimeve shkencore të nevojshme për përmirësimin e administrimit të pyjeve. Gjithashtu, kjo ul transparencën dhe përgjegjshmërinë institucionale dhe krijon mundësi për keqmenaxhim ose moszbatim të detyrimeve ligjore.<br>**Shkaku:** Ky problem ka ardhur si pasojë e mungesës së një sistemi të plotë monitorimi dhe arkivimi të dokumentacionit përkatës, si dhe dobësive në procesin e kontrollit të brendshëm për ndjekjen e procedurave standarde për trajnimin e pronarëve/përdoruesve dhe zhvillimin e kërkimeve shkencore. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I mesëm. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka siguruar dokumentacionin e nevojshëm që vërteton marrjen e masave për mbështetjen e pronarëve dhe përdoruesve të fondit pyjor dhe për zhvillimin e kërkimeve shkencore, gjë që përbën një mangësi të dukshme në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në zbatimin e legjislacionit në fuqi. |
| **Rekomandimi** | Drejtoria të sigurojë dokumentimin dhe arkivimin e plotë të masave të ndërmarra për trajnimin dhe mbështetjen e pronarëve/përdoruesve të fondit pyjor dhe për zhvillimin e kërkimeve shkencore, në përputhje me ligjin dhe akteve nënligjore në fuqi. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

28. ***Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:***

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe aktiviteteve të Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, rezulton se sistemi aktual i menaxhimit të pyjeve përballet me mangësi të dukshme në disa aspekte kyçe të zbatimit të detyrimeve ligjore dhe të kontrollit të brendshëm.*

*Auditimi evidentoi se mungojnë evidencat që vërtetojnë kryerjen e inspektimeve pyjore, trajtimin drusor dhe furnizimin me dru zjarri, si dhe masat për monitorimin e mirëmbajtjes dhe funksionimit të infrastrukturës pyjore. Po ashtu, rezulton se nuk ka dokumentacion të mjaftueshëm që të tregojë mbikëqyrjen e punës për përmirësimin e zonave të gërryera dhe*

*parandalimin e fenomeneve natyrore si erozioni, rrëshkitjet dhe ortekët, si dhe mbështetjen e pronarëve dhe përdoruesve të fondit pyjor përmes trajnimeve dhe zhvillimit të kërkimeve shkencore.*

*Këto mangësi ndikojnë direkt në rrezikun e mosrespektimit të kuadrit ligjor (Ligji Nr.57/2020 "Për Pyjet", (i ndryshuar), përdorimin joefikas të burimeve pyjore, uljen e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale, si dhe krijojnë mundësi për keqmenaxhim, dëmtime të pasurisë pyjore dhe shkelje të procedurave të furnizimit të qytetarëve.*

*Shkaku kryesor i këtyre dobësive lidhet me mungesën e një sistemi të plotë monitorimi dhe arkivimi të dokumentacionit, si dhe dobësitë në mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe ndjekjes së procedurave standarde për administrimin, inspektimin, mirëmbajtjen, trajtimin drusor, furnizimin dhe mbështetjen e përdoruesve të fondit pyjor.*

*Në përfundim, sistemi i menaxhimit të pyjeve në Drejtorinë e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit kërkon përmirësim të menjëhershëm në nivelin e dokumentimit, monitorimit, mbikëqyrjes dhe raportimit të aktiviteteve pyjore. Implementimi i rekomandimeve të paraqitura në gjetjet e auditimit është thelbësor për të garantuar respektimin e ligjit, përdorimin efikas të burimeve natyrore, rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale.*

## 29. 4.3 SISTEMI I MENAXHIMIT TË KULLOTAVE

**27. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se nuk është hartuar nga ana e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, pas miratimit në parim nga Kryetari i Bashkisë i listës së propozuar me sipërfaqet pyjore/kullosore për përdorim, studimi përkatës sipas kritereve ligjore.

| **Nr. i Gjetjes 27** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit nuk ka hartuar studimin përkatës mbi sipërfaqet pyjore/kullosore për përdorim, pas miratimit në parim nga Kryetari i Bashkisë të listës së propozuar, sipas kritereve ligjore. |

| | |
|---|---|
| | **Kriteri:** Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" , pika 4.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtij studimi mund të çojë në përdorim jo të rregullt ose jo të ligjshëm të sipërfaqeve pyjore/kullosore, duke rritur rrezikun për keqmenaxhim të pasurisë pyjore dhe mungesë transparence në procesin e vendimmarrjes.<br>**Shkaku:** Nuk janë respektuar procedurat ligjore, duke çuar në moshartimin e studimeve të nevojshme. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka përmbushur detyrimet ligjore për hartimin e studimeve të nevojshme mbi sipërfaqet pyjore/kullosore, duke u larguar nga praktikat e duhura administrative dhe legjislacioni në fuqi. |
| **Rekomandimi** | Të hartohet menjëherë studimi përkatës mbi sipërfaqet pyjore/kullosore për përdorim, duke respektuar kriteret ligjore dhe procedurat e miratimit, dhe të sigurohet dokumentacioni i plotë për çdo vendim të Kryetarit të Bashkisë lidhur me përdorimin e këtyre sipërfaqeve. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**28. Titulli i Gjetjes:** Nuk janë hartuar Raportet Tekniko-Ekonomike në përputhje me Shtojcën Nr.1 të Udhëzimit Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

| **Nr. i Gjetjes 28** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |

| | |
|---|---|
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik". |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se nuk janë hartuar Raportet Tekniko-Ekonomike në përputhje me Shtojcën Nr.1 të Udhëzimit Nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".<br>**Kriteri:**Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" , Shtojca Nr. 1.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e Raporteve Tekniko-Ekonomike të rregullta rrit rrezikun e vendimeve të pabazuara në ligj për përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, duke minuar transparencën dhe llogaridhënien e drejtorisë.<br>**Shkaku:** Mungesa e njohurive të mjaftueshme të stafit për udhëzimet ligjore dhe/ose moszbatimi i procedurave të brendshme të drejtorisë ka çuar në moshartimin e raporteve sipas kërkesave ligjore. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka përmbushur detyrimet ligjore dhe udhëzuese për hartimin e Raporteve Tekniko-Ekonomike sipas standardeve të përcaktuara në Udhëzimin Nr. 1, duke shkelur procedurat e miratimit të kërkesave për përdorim të fondit pyjor dhe kullosor. |
| **Rekomandimi** | Të hartohen menjëherë Raportet Tekniko-Ekonomike në përputhje me Shtojcën Nr.1 të Udhëzimit Nr.1, duke siguruar që të gjitha kërkesat për përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor publik të dokumentohen dhe të shqyrtohen sipas procedurave ligjore. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**29. Titulli i Gjetjes:** Nuk janë plotësuar Formularët nr.1, 2, 3, 4, 5 sipas formatit dhe parashikimeve të Udhëzimit Nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

| Nr. i Gjetjes 29 | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Formularët nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5 nuk janë plotësuar sipas formatit dhe parashikimeve të Udhëzimit Nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".<br>**Kriteri:** Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".<br>**Ndikimi/Efekti:** Plotësimi jo korrekt i formularëve mund të çojë në keqinterpretim të kërkesave për përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor, duke rritur rrezikun për vendime jo të ligjshme dhe mungesë transparence në procesin administrativ.<br>**Shkaku:** Mungesa e njohurive të stafit mbi formatin dhe procedurat e detajuara në Udhëzimin Nr. 1, ose moszbatimi i rregullave të brendshme administrative, ka sjellë mosplotësimin e formularëve. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka respektuar udhëzimet ligjore dhe format standarde për plotësimin e formularëve, duke cenuar procesin e miratimit të kërkesave për përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik. |
| **Rekomandimi** | Të plotësohen Formularët nr. 1–5 sipas formatit dhe udhëzimeve të Udhëzimit Nr. 1, duke siguruar që çdo kërkesë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor publik të dokumentohet dhe shqyrtohet në përputhje me ligjin. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**30. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se mungojnë evidencat mbi zbatimin e procedurës së kërkuar nga Udhëzimi Nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", për vlerësimin e ofertave dhe shpalljen e subjektit fitues.

| **Nr. i Gjetjes 30** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se mungojnë evidencat mbi zbatimin e procedurës së kërkuar nga Udhëzimi Nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", për vlerësimin e ofertave dhe shpalljen e subjektit fitues.<br>**Kriteri:** Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", pika 7-15.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtyre evidencave rrit rrezikun për vendime jo transparente dhe jo të ligjshme, duke cenuar procesin konkurrues dhe llogaridhënien.<br>**Shkaku:** Mungesa e dokumentimit të plotë ose mosrespektimi i procedurave të brendshme ka çuar në mungesën e evidencave të nevojshme për çdo hap të procesit të vlerësimit dhe shpalljes së fituesit. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka dokumentuar procesin e vlerësimit të ofertave dhe shpalljes së subjektit fitues sipas udhëzimeve ligjore, duke shkelur procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Nr. 1. |
| **Rekomandimi** | Të sigurohet dokumentacioni i plotë mbi çdo hap të procesit të vlerësimit dhe shpalljes së ofertave fituese, duke respektuar procedurat e Udhëzimit Nr. 1 dhe duke ruajtur transparencën dhe llogaridhënien administrative. |

| | |
|---|---|
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë dhe në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**31. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, rezuton se, për vitin 2024 janë lidhur 56 kontrata në total, nga të cilat mungojnë në dosjen e dorëzuar për auditim Kontrata me Nr. 32, 37 dhe 49.

| **Nr. i Gjetjes 31** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (*i ndryshuar*).<br>• Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik". |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se, për vitin 2024, janë lidhur 56 kontrata në total, por në dosjen e dorëzuar për auditim mungojnë Kontratat me Nr. 32, 37 dhe 49.<br>**Kriteri:**Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar) dhe Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e kontratave të dokumentuara rrit rrezikun për verifikim të pamjaftueshëm të detyrimeve kontraktuale, mundësi për keqinterpretim të marrëveshjeve dhe zvogëlon transparencën e procesit të menaxhimit të kontratave.<br>**Shkaku:** Mungesa e kontratave në dosjen e auditimit mund të jetë pasojë e organizimit jo të mirë të dokumentacionit ose mosrespektimit të procedurave të arkivimit dhe administrimit të kontratave nga ana e drejtorisë. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |

| | |
|---|---|
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka siguruar dokumentacion të plotë të kontratave për vitin 2024, duke cenuar procesin e auditimit dhe monitorimit të detyrimeve kontraktuale. |
| **Rekomandimi** | Të plotësohen menjëherë dosjet e kontratave të munguara dhe të sigurohet që të gjitha kontratat e ardhshme të ruhen dhe arkivohen sipas procedurave të brendshme dhe legjislacionit në fuqi. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | Është paraqitur observacion. |

<u>**32. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se, për lidhjen e kontratave të qirasë, janë marrë 56 vendime, nga të cilëtt mungon vendimi Nr. 32.</u>

| **Nr. i Gjetjes 32** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar).<br>• Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se, për lidhjen e kontratave të qirasë, janë marrë 56 vendime, por mungon vendimi Nr. 32 në evidenca.<br>**Kriteri:** Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar) dhe Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e vendimit rrit rrezikun për vendimmarrje të paplotë ose të pasaktë lidhur me kontratat e qirasë, dhe zvogëlon transparencën dhe llogaridhënien ndaj autoriteteve kontrolluese.<br>**Shkaku:** Mungesa e vendimit mund të jetë për shkak të organizimit jo të mirë të dokumentacionit ose mosrespektimit të procedurave të brendshme administrative për ruajtjen dhe arkivimin e vendimeve. |

| | |
|---|---|
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka siguruar dokumentacion të plotë për vendimet mbi kontratat e qirasë, duke cenuar monitorimin dhe auditimin e procesit të lidhjes së kontratave. |
| **Rekomandimi** | Të gjendet dhe të arkivohet vendimi Nr. 32 dhe të sigurohet që të gjitha vendimet për kontratat e ardhshme të ruhen dhe dokumentohen sipas procedurave të brendshme dhe legjislacionit në fuqi. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | Është paraqitur observacion. |

<u>**33. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se për 2 vendime, përkatësisht Nr. 37 dhe Nr. 49, mungojnë kontratat respektive.</u>

| **Nr. i Gjetjes 33** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar).<br>• Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se për 2 vendime, Nr. 37 dhe Nr. 49, mungojnë kontratat respektive.<br>**Kriteri:** Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar) dhe Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"<br>**Ndikimi/Efekti:**Mungesa e kontratave për këto vendime rrit rrezikun e mosverifikimit të detyrimeve kontraktuale dhe zvogëlon transparencën dhe llogaridhënien administrative.<br>**Shkaku:** Mungesa e kontratave mund të jetë për shkak të organizimit të dobët të |

| | |
|---|---|
| | dokumentacionit ose mosrespektimit të procedurave të arkivimit dhe administrimit të kontratave nga drejtoria. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka siguruar dokumentacion të plotë për kontratat lidhur me vendimet Nr. 37 dhe Nr. 49, duke cenuar procesin e auditimit dhe monitorimit. |
| **Rekomandimi** | Të plotësohen kontratat e munguara për vendimet Nr. 37 dhe Nr. 49 dhe të sigurohet që të gjitha kontratat e ardhshme të ruhen dhe dokumentohen sipas procedurave të brendshme dhe legjislacionit në fuqi. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**34. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se mungojnë Proces-Verbalet për marrjen në dorëzim të sipërfaqeve, sipas kontratave të qirasë.

| **Nr. i Gjetjes 34** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar).<br>• Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se mungojnë Proces-Verbalet për marrjen në dorëzim të sipërfaqeve, sipas kontratave të qirasë.<br>**Kriteri:** Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar) dhe Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e Proces-Verbaleve rrit rrezikun për mosverifikim të |

| | |
|---|---|
| | marrjes reale të sipërfaqeve dhe zvogëlon transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e kontratave të qirasë.<br>**Shkaku:** Mungesa e Proces-Verbaleve mund të jetë për shkak të moszbatimit të procedurave të brendshme për dokumentimin e dorëzimit të sipërfaqeve ose organizimit jo të mirë të arkivit të dokumentacionit. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka dokumentuar në mënyrë të plotë marrjen në dorëzim të sipërfaqeve të kontraktuara, duke cenuar procesin e auditimit dhe kontrollin e përdorimit të fondeve pyjore dhe kullosore. |
| **Rekomandimi** | Të hartohen dhe të ruhen Proces-Verbalet për marrjen në dorëzim të të gjitha sipërfaqeve sipas kontratave të qirasë dhe të sigurohet që ky dokumentim të bëhet për çdo kontratë të ardhshme. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

<u>35. Titulli i Gjetjes: Nga dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se mungojnë evidencat mbi kontratat e lidhura në vitin 2025.</u>

| **Nr. i Gjetjes 35** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar).<br>• Udhëzim Nr.2 , datë 20.7.2016 " Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari" |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se mungojnë evidencat mbi kontratat e lidhura në vitin 2025.<br>**Kriteri:** Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar) dhe Udhëzim |

| | |
|---|---|
| | Nr.2, datë 20.7.2016 " Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", pika 12.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e këtyre evidencave rrit rrezikun për mosverifikim të detyrimeve kontraktuale dhe pengon auditimin e plotë të menaxhimit të kontratave, duke ulur transparencën dhe llogaridhënien administrative.<br>**Shkaku:** Mungesa e dokumentacionit mund të jetë për shkak të organizimit jo të mirë të arkivit, mosrespektimit të procedurave të brendshme për regjistrimin dhe ruajtjen e kontratave, ose vonesave në dorëzimin e kontratave nga palët kontraktuese. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka siguruar dokumentacion të plotë për kontratat e vitit 2025, duke cenuar procesin e auditimit dhe monitorimit të përdorimit të fondeve pyjore dhe kullosore. |
| **Rekomandimi** | Të sigurohen menjëherë evidencat e kontratave të lidhura në vitin 2025 dhe të vendosen procedura të qarta për regjistrimin dhe ruajtjen e të gjitha kontratave të ardhshme në përputhje me legjislacionin dhe procedurat e brendshme. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**36. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se mungojnë kërkesat e subjekteve të interesuara për marrjen e kullotave me qira.

| **Nr. i Gjetjes 36** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (*i ndryshuar*).<br>• Udhëzim Nr.2, datë 20.7.2016 " Për kriteret teknike të klasifikimit të |

| | |
|---|---|
| | kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari". |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se mungojnë kërkesat e subjekteve të interesuara për marrjen e kullotave me qira<br>**Kriteri:** Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar) dhe Udhëzim Nr.2, datë 20.7.2016 " Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", pika 2.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e kërkesave të subjekteve të interesuara pengon procesin e vlerësimit të ofertave dhe përzgjedhjen e subjektit fitues në mënyrë transparente, duke rritur rrezikun për vendime të padrejta dhe mungesë llogaridhënie.<br>**Shkaku:**Mungesa e këtyre kërkesave mund të jetë për shkak të moszbatimit të procedurave për pranimin dhe regjistrimin e kërkesave nga drejtoria ose organizimit jo të mirë të arkivit të dokumentacionit. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka dokumentuar kërkesat e subjekteve për marrjen e kullotave me qira, duke cenuar procesin e auditimit dhe transparencën e vendimmarrjes. |
| **Rekomandimi** | Të sigurohet regjistrimi dhe ruajtja e të gjitha kërkesave të subjekteve për marrjen e kullotave me qira dhe të zbatohet procedura e plotë e vlerësimit dhe përzgjedhjes së subjektit fitues sipas Udhëzimit Nr. 1, datë 9.6.2016. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**37. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se mungon dokumentacioni shoqërues i kërkesës për marrjen me qira, përkatësisht certifikata veterinare, vërtetimi nga njësia administrative për vendbanimin dhe numrin e bagëtive si dhe lista e objekteve që kërkohet të ndërtohen në ndihmë të kullotjes.

| **Nr. i Gjetjes 37** | |
|---|---|
| **Subjekti i** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |

| Audituar | |
|---|---|
| Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| Përmbledhja e bazës ligjore | • Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (*i ndryshuar*).<br>• Udhëzim Nr.2, datë 20.7.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari". |
| Përshkrimi i gjetjes | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se mungon dokumentacioni shoqërues i kërkesës për marrjen me qira të kullotave, përkatësisht certifikata veterinare, vërtetimi nga njësia administrative për vendbanimin dhe numrin e bagëtive, si dhe lista e objekteve që kërkohet të ndërtohen në ndihmë të kullotjes.<br>**Kriteri:** Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar) dhe Udhëzim Nr.2, datë 20.7.2016 " Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", pika 5.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e dokumentacionit shoqërues rrit rrezikun për marrje vendimesh të paplota ose jo të ligjshme për qiradhënien e kullotave dhe pengon verifikimin e plotë të kërkesave nga auditimi.<br>**Shkaku:** Mungesa e dokumentacionit mund të vijë si pasojë e moszbatimit të procedurave të pranimit dhe kontrollit të kërkesave nga drejtoria, ose nga organizimi jo i mirë i arkivit të dokumentacionit. |
| Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët) | I lartë. |
| Konkluzioni | Drejtoria nuk ka siguruar dokumentacion të plotë shoqërues për kërkesat e qiradhënies së kullotave, duke cenuar procesin e verifikimit dhe auditimit të përdorimit të sipërfaqeve pyjore/kullosore. |
| Rekomandimi | Të sigurohet dokumentacioni i plotë shoqërues për çdo kërkesë për marrjen me qira të kullotave, duke përfshirë certifikatën veterinare, vërtetimin e njësisë administrative dhe listën e objekteve për ndihmë të kullotjes, dhe të zbatohet procedura e plotë e kontrollit sipas Udhëzimit Nr. 1, datë 9.6.2016. |
| Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit | Në vijimësi. |
| Statusi i rekomandimit | I pranuar. |

**38. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se nuk janë respektuar afatet ligjore për shqyrtimin e kërkesave dhe lidhjes së kontratave.

| Nr. i Gjetjes 38. | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit. |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (*i ndryshuar*).<br>• Udhëzim Nr.2, datë 20.7.2016 " Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari". |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se nuk janë respektuar afatet ligjore për shqyrtimin e kërkesave dhe lidhjen e kontratave.<br>**Kriteri:** Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar) dhe Udhëzim Nr.2, datë 20.7.2016 " Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", pika 3 dhe 9.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mosrespektimi i afateve ligjore rrit rrezikun për vonesa në lidhjen e kontratave, mund të çojë në shkelje të ligjit dhe zvogëlon transparencën dhe llogaridhënien në procesin administrativ.<br>**Shkaku:**Mosrespektimi i afateve mund të vijë si pasojë e organizimit jo të mirë të procedurave të brendshme, mungesës së stafit të mjaftueshëm ose vonesave administrative gjatë procesit të shqyrtimit dhe miratimit të kontratave. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka zbatuar afatet ligjore për shqyrtimin e kërkesave dhe lidhjen e kontratave, duke cenuar procesin e menaxhimit të kontratave dhe auditimin e tyre. |
| **Rekomandimi** | Të respektohen afatet ligjore për shqyrtimin e kërkesave dhe lidhjen e kontratave dhe të vendosen mekanizma për monitorim të brendshëm që sigurojnë zbatimin e afateve në të gjitha rastet e ardhshme. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |

| | |
|---|---|
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**39. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se nga ana e qiradhënësit nuk është bërë asnjë sondazh gjatë periudhës së kullotjes.

| **Nr. i Gjetjes 39.** | |
|---|---|
| **Subjekti i Auditua r** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (*i ndryshuar*).<br>• Udhëzim Nr.2, datë 20.7.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari". |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se, nga ana e qiradhënësit, nuk është bërë asnjë sondazh gjatë periudhës së kullotjes.<br>**Kriteri:** Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar) dhe Udhëzim Nr.2, datë 20.7.2016 " Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", pika 7, kreu iii.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mosrealizimi i sondazheve rrit rrezikun për përdorim jo të rregullt të kullotave, humbje të mundshme të resurseve pyjore dhe kullosore dhe zvogëlon mundësinë për verifikim të plotë nga auditimi.<br>**Shkaku:**Mungesa e sondazheve mund të jetë për shkak të moszbatimit të procedurave të monitorimit të kullotjeve nga drejtoria ose mungesës së mekanizmave të kontrollit të vazhdueshëm gjatë periudhës së qiradhënies. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I ulët. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka kryer monitorimin e nevojshëm gjatë periudhës së kullotjes, duke cenuar procesin e menaxhimit të sipërfaqeve pyjore/kullosore dhe auditimin e tyre. |
| **Rekomandimi** | Të vendosen procedura të qarta dhe të zbatohet monitorimi i rregullt i kullotjeve nga qiradhënësi, përfshirë realizimin e sondazheve periodike gjatë gjithë periudhës së qiradhënies, për të garantuar përdorim të ligjshëm dhe të qëndrueshëm të kullotave. |

| | |
|---|---|
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**40. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se mungojnë Proces-Verbalet e mbledhjeve nga struktura përkatëse për shqyrtimin e kërkesave.

| **Nr. i Gjetjes 40** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (*i ndryshuar*).<br>• Udhëzim Nr.2, datë 20.7.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari". |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se mungojnë Proces-Verbalet e mbledhjeve nga struktura përkatëse për shqyrtimin e kërkesave.<br>**Kriteri:** Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar) dhe Udhëzim Nr.2, datë 20.7.2016 " Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", pika 9, kreu ii.<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e Proces-Verbaleve pengon verifikimin e mënyrës së shqyrtimit të kërkesave, zvogëlon transparencën dhe rrit rrezikun për vendime jo të dokumentuara dhe jo të ligjshme.<br>**Shkaku:**Mungesa e Proces-Verbaleve mund të jetë për shkak të moszbatimit të procedurave për dokumentimin e mbledhjeve ose organizimit jo të mirë të arkivit të dokumentacionit nga struktura përkatëse. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Struktura përkatëse nuk ka siguruar dokumentacion të plotë mbi mbledhjet për shqyrtimin e kërkesave, duke cenuar procesin e auditimit dhe llogaridhënien administrative. |

| | |
|---|---|
| **Rekomandimi** | Të hartohen dhe të ruhen Proces-Verbalet për çdo mbledhje të strukturës përkatëse mbi shqyrtimin e kërkesave dhe të sigurohet që ky dokumentim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha mbledhjet e ardhshme. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

**41. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, mungojnë evidencat mbi përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor të cila dërgohen në strukturën përkatëse të Ministrisë së Mjedisit brenda datës 10 të çdo muaji.

| **Nr. i Gjetjes 41** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar).<br>• Udhëzim Nr.2 , datë 20.7.2016 " Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari" |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se mungojnë evidencat mbi përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor, të cilat duhet të dërgohen në strukturën përkatëse të Ministrisë së Mjedisit brenda datës 10 të çdo muaji.<br>**Kriteri:** Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar) dhe Udhëzim Nr.2, datë 20.7.2016 " Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", pika 1, kreu v<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e evidencave zvogëlon transparencën dhe llogaridhënien ndaj Ministrisë së Mjedisit, rrit rrezikun për raportim të pasaktë ose të vonuar dhe pengon auditimin e përdorimit të fondeve pyjore dhe kullosore.<br>**Shkaku:**Mungesa e këtyre evidencave mund të jetë për shkak të moszbatimit të procedurave të raportimit mujor ose organizimit të dobët të regjistrimit dhe përpilimit të dokumentacionit nga drejtoria. |

| | |
|---|---|
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I mesëm. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka siguruar evidencat e përdorimit të fondeve pyjore dhe kullosore sipas afateve ligjore, duke cenuar procesin e monitorimit dhe auditimit. |
| **Rekomandimi** | Të dorëzohen menjëherë evidencat e përdorimit të fondeve pyjore dhe kullosore dhe të vendosen procedura të rrepta për raportim mujor në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë dhe në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

<u>**42.Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se mungojnë evidencat mbi informimin me shkrim të bashkisë nga ana e subjekteve qiramarrëse mbi ecurinë e veprimtarisë së tyre dhe problematikave të hasura.</u>

| **Nr. i Gjetjes 42** | |
|---|---|
| **Subjekti i AuditUar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (*i ndryshuar*).<br>• Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", pika 19, d). |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se mungojnë evidencat mbi informimin me shkrim të bashkisë nga ana e subjekteve qiramarrëse lidhur me ecurinë e veprimtarisë së tyre dhe problematikat e hasura gjatë zbatimit të kontratave.<br>**Kriteri:** Ligji Nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar) dhe Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 " Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këresave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", |

| | |
|---|---|
| | pika 19, d).<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e informimit me shkrim pengon monitorimin e rregullt të kontratave, ul transparencën dhe rrit rrezikun për shfaqjen e problematikave të paadresuara në kohë nga ana e bashkisë.<br>**Shkaku:**Kjo situatë mund të vijë si pasojë e mosrespektimit të detyrimeve kontraktuale nga qiramarrësit, mungesës së mekanizmave të monitorimit nga ana e bashkisë apo mungesës së ndjekjes së rregullt të raportimeve të kërkuara. |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I mesëm. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria nuk ka siguruar evidencat e raportimeve të subjekteve qiramarrëse, duke cenuar procesin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së veprimtarive të lidhura me përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor. |
| **Rekomandimi** | Të kërkohet zbatimi i detyrimit kontraktual nga subjektet qiramarrëse për informimin me shkrim mbi ecurinë e veprimtarisë dhe problematikat e hasura, si dhe të vendosen mekanizma monitorimi për ndjekjen e rregullt të këtyre raportimeve. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë dhe në vijimësi. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

30. ***Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:***

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor nga Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, rezulton se procedurat ligjore dhe administrative nuk janë respektuar plotësisht, duke u konstatuar mangësi të konsiderueshme në përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit shoqërues. Në mënyrë të përsëritur u evidentuan mungesa të raporteve tekniko-ekonomike, formularëve të detyrueshëm, kontratave dhe vendimeve përkatëse, si dhe mungesë e procesverbaleve të marrjes në dorëzim të sipërfaqeve, të mbledhjeve të strukturave përkatëse dhe e sondazheve gjatë periudhës së kullotjes. Gjithashtu, nuk janë respektuar afatet ligjore për shqyrtimin e kërkesave dhe lidhjen e kontratave, ndërsa evidencat mbi raportimet mujore ndaj Ministrisë së Mjedisit dhe informimet nga subjektet qiramarrëse mbi ecurinë e veprimtarisë kanë munguar. Këto problematika tregojnë për një mungesë të mekanizmave efektivë të monitorimit, kontrollit dhe arkivimit të dokumentacionit, duke cenuar transparencën, llogaridhënien dhe sigurinë juridike të proceseve të dhënies me qira të pasurisë publike. Në këtë kuadër, është i domosdoshëm forcimi i sistemit të menaxhimit dhe raportimit,*

*zbatimi rigoroz i kuadrit ligjor dhe vendosja e procedurave të qarta të kontrollit, me qëllim sigurimin e një administrimi të rregullt, transparent dhe të qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor.*

31. **4.4 SISTEMI I GJUETISË**

**43. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar për auditim, mungojnë evidencat mbi masat e marra nga ana e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit mbi përmbushjen e detyrave mbi sistemin e gjuetisë.

| **Nr. i Gjetjes 43** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr. 10 253, datë 11.3.2010 "Për Gjuetinë". |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Gjatë auditimit u konstatua se Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion apo evidencë që të dëshmojë marrjen e masave për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për sa i përket monitorimit të gjuetisë dhe bashkëpunimit me strukturat e posaçme dhe menaxhuesit e zonave të gjuetisë. Po ashtu, mungojnë të dhënat mbi zbatimin e programit të monitorimit të gjuetisë, përfshirë treguesit për ndjekjen e faunës, llojet e lejuara për gjueti si dhe raportimet periodike.<br>**Kriteri:** Neni 54, pika 3 dhe neni 57, pika 1e Ligjit Nr. 10 253, datë 11.3.2010 "Për Gjuetinë".<br>**Ndikimi/Efekti:** Moszbatimi i detyrimeve për monitorimin e gjuetisë dhe mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional krijon rrezik për gjueti të paligjshme, dëmtim të faunës së egër dhe humbje të kontrollit mbi burimet natyrore në territorin e bashkisë. Mungesa e evidencës mbi treguesit biologjikë dhe ekologjikë pengon hartimin e politikave përkatëse për menaxhimin e gjuetisë dhe mbrojtjen e biodiversitetit.<br>**Shkaku:** Situata ka ardhur si pasojë e mungesës së angazhimit institucional dhe bashkëpunimit të strukturuar ndërmjet Drejtorisë së Pyjeve, Policisë Pyjore dhe subjekteve të tjera të ngarkuara nga ligji. |

| | |
|---|---|
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të garantuar zbatimin e legjislacionit për gjuetinë dhe për të monitoruar zhvillimet në këtë fushë, në bashkëpunim me strukturat e tjera përgjegjëse. Kjo situatë përbën mospërputhje me kërkesat ligjore për mbrojtjen e faunës dhe menaxhimin e burimeve natyrore. |
| **Rekomandimi** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për të organizuar dhe zbatuar në praktikë detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për gjuetinë. Po ashtu, duhet të hartohet dhe zbatohet një program i rregullt i monitorimit të gjuetisë, të bëhet mbledhja dhe analizimi i të dhënave mbi treguesit biologjikë dhe ekologjikë si dhe raportimi periodik në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

32. ***Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:***

*Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur për auditim nga ana e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit si dhe vlerësimi i veprimtarisë së kësaj drejtorie, evidentohet se sistemi i monitorimit të gjuetisë nuk është funksional dhe nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në Ligjin nr. 10 253, datë 11.3.2010 "Për Gjuetinë". Struktura përgjegjëse nuk ka hartuar, zbatuar apo raportuar ndonjë program monitorimi të gjuetisë dhe nuk ka siguruar mbledhjen, përpunimin apo analizimin e të dhënave mbi gjendjen e faunës së egër dhe aktivitetin e gjuetisë në territorin e bashkisë. Po ashtu, mungon bashkëpunimi funksional me strukturën përgjegjëse, menaxhuesit e zonave të gjuetisë dhe organet e tjera të përcaktuara me ligj, duke sjellë problematika në zbatimin e kontrollit institucional.*

*Kjo analizë tregon për një mosangazhim të qartë institucional në përmbushjen e detyrimeve ligjore, cenon integritetin e burimeve natyrore dhe rrit rrezikun për gjueti të paligjshme dhe dëmtim të biodiversitetit. Në mungesë të një sistemi të rregullt monitorimi dhe raportimi, bashkia nuk është në gjendje të planifikojë apo zbatojë politika efektive të menaxhimit të faunës, duke vënë në rrezik ruajtjen dhe menaxhimin afatgjatë të zonave të gjuetisë.*

*Në përfundim, vlerësohet se sistemi i monitorimit të gjuetisë në nivel vendor është i pazhvilluar, jo funksional dhe në kundërshtim me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të natyrës, gjë që kërkon ndërhyrje të menjëhershme për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.*

33. **4.5 SISTEMI I MENAXHIMIT KADASTRAL**

**44. Titulli i Gjetjes:** Nga dokumentacioni i dorëzuar për auditim, mungojnë evidencat mbi masat e marra nga ana e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit mbi përmbushjen e detyrave mbi sistemin e menaxhimit kadastral.

| **Nr. i Gjetjes 44** | |
|---|---|
| **Subjekti i Audituar** | **Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit** |
| **Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja** | • Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit |
| **Përmbledhja e bazës ligjore** | • Ligji Nr.57/2020 "Për Pyjet" *(I ndryshuar).*<br>• VKM Nr. 171, datë 18.03.2022 "Për ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe Regjistrin e Fondit Kullosor, përcaktimin e strukturës, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dheënave në nivel vendor, rajonal e qëndror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve". |
| **Përshkrimi i gjetjes** | **Situata:** Gjatë procesit të auditimit u konstatua se Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, si struktura përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor në nivel vendor, nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë ngritjen, funksionimin dhe përditësimin periodik të Regjistrit të Fondit Pyjor në territorin e bashkisë, si pjesë e Regjistrit Kombëtar të Fondit Pyjor (RKFP). Gjithashtu, nuk u paraqitën evidenca që të provojnë mbledhjen dhe administrimin e të dhënave mbi gjendjen dhe zhvillimin e pyjeve publike e private, ruajtjen e ekuilibrit biologjik, si dhe menaxhimin e rasteve të sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve në fondin pyjor vendor.<br>**Kriteri:** Neni 16 dhe 17 i Ligjit Nr.57/2020 "Për Pyjet" *(I ndryshuar).*<br>VKM Nr. 171, datë 18.03.2022 "Për ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe Regjistrin e Fondit Kullosor, përcaktimin e strukturës, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të |

| | |
|---|---|
| | ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dheënave në nivel vendor, rajonal e qëndror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve".<br>**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e dokumentacionit dhe e funksionalitetit të regjistrit pyjor në nivel vendor pengon administrimin efektiv të fondit pyjor, si dhe kufizon kapacitetin planifikues dhe vendimmarrës të bashkisë në lidhje me politikat e menaxhimit të pyjeve. Kjo situatë krijon rrezik për keqmenaxhim, degradim të burimeve pyjore dhe mosidentifikim në kohë të rreziqeve natyrore si zjarret apo dëmtuesit biologjikë.<br>**Shkaku:** Analiza e kryer tregon se kjo situatë ka ardhur si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve ligjore nga struktura përgjegjëse si dhe për shkak të mungesës së organizimit të brendshëm, burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe kapaciteteve teknike për implementimin e sistemit të regjistrimit dhe të sistemit të informacionit gjeografik (GIS). |
| **Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)** | I lartë. |
| **Konkluzioni** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar funksionalitetin e regjistrit të fondit pyjor vendor dhe për të garantuar përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor për pyjet. Kjo situatë përbën mospërputhje me kërkesat ligjore dhe teknike për menaxhimin e qëndrueshëm të pasurive pyjore. |
| **Rekomandimi** | Njësia e audituar duhet të marrë masa të menjëhershme për ngritjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit të Fondit Pyjor në nivel vendor, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke siguruar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mbi fondin pyjor publik dhe privat, përfshirë evidencat mbi sëmundjet, dëmtuesit dhe zjarret. |
| **Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit** | Menjëherë. |
| **Statusi i rekomandimit** | I pranuar. |

34. ***Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:***

*Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur, rezulton se sistemi i menaxhimit kadastral të fondit pyjor në nivel vendor, nuk është funksional dhe nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Mungesa e regjistrit pyjor vendor,si pjesë e RKFP dhe e*

*evidencave mbi të dhënat kadastrale si dhe e raportimeve periodike, tregon për një moszbatim të detyrimeve ligjore dhe për një nivel të lartë rreziku në menaxhimin e pasurive pyjore.*

*Gjendja aktuale tregon për mangësi të konsiderueshme në njësinë së audituar, duke përfshirë shmangien nga kryerja e detyrave funksionale dhe të infrastrukturës teknologjike (p.sh. sistemi GIS), gjë kjo që e bën të pamundur monitorimin, planifikimin dhe administrimin në mënyrë të qëndrueshme të fondit pyjor vendor.*

*Për rrjedhojë, vlerësohet se sistemi aktual i menaxhimit kadastral pyjor në bashki nuk është efektiv, nuk funksionon sipas kërkesave ligjore dhe nuk siguron transparencë dhe kontroll të duhur mbi pasuritë pyjore, duke lënë vend për keqmenaxhim dhe degradim të mundshëm të tyre.*

## 35. V. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA MË PARË

Nga auditimi i kryer në vitin 2023 (auditimi i fundit) në Drejtorinë e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, është mbuluar me auditim periudha e veprimtarisë për vitin 2023 dhe sistemet dhe fushat e audituara kanë përfshirë sistemin e menaxhimit të pyjeve dhe sistemin e menaxhimit të kullotave. Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se është hartuar Plani i Veprimit për ndjekjen e këtyre rekomandimeve, por nuk ka ndjekur formatin standard të caktuar, gjë kjo e cila ju është vënë në djeni me Shkresën Nr. 3478 Prot., datë 17.07.2024. Nga 8 (tetë) rekomandimet e dhëna për Drejtorinë e Pyjeve, Parqeve dheRekreacionit, njësianuk ka reaguar dhe nuk ka dërguar asnjë lloj informacioni,dokumenti mbi progresin e ndjekjes së rekomandimeve. Më konkretisht verifikimi i statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm është si vijon:

**Rekomandim Nr. 1:**

Të merren masa të menjëhershme nga ana e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit dhe nga personat specialistë përgjegjës që kanë lejuar krijimin e këtyre debitorëve për njoftimin e tyre dhe shlyerjen e tepricës debitore nga fermerët.

**Statusi:** Janë bërë njoftimet për fermerët debitorë.

**Rekomandim Nr. 2:**

Nga ana e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit dhe specialistët përgjegjes në sektorin e kullotave të zbatojnë ''Udhëzimin'' Nr. 02. datë 20.06.2016 dhe procedurat e dhënies së kullotave. Protokolli të pasqyrojë drejt kërkesën për sasinë sipas raportit veterinar dhe vërtetimit të njësisë administrative për të llogaritur në mënyrë të drejtë vlerën reale sipas paketës fiskale të miratuar në Këshillin Bashkiak. Në vazhdim të mos lejohet hyrja e fermerëve në parcelë pa marrë miratim nga Këshilli Bashkiak.

**Statusi:** I përmbushur.

**Rekomandim Nr. 3:**

Nga ana e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit dhe specialistëve që mbulojnë këtë sektor së bashku me specialistët përgjegjës të çdo njësie të ngrejnë grupet e punës dhe perpilimin e proces-verbalit në njësi për çdo fermer që disponon këta krerë dhe të hapet Regjistri për Fermerët e Mëdhenj me rimbursim nga shteti.

**Statusi:** Është bashkëpunuar me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

**Rekomandim Nr. 4:**

Nga ana e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit dhe specialistëve që mbulojnë këtë sektor së bashku me specialistët përgjegjës të çdo njesie të ngrejnë grupet e punës dhe

perpilimin e proces-verbalit në njësi për çdo fermer që disponon këta krerë dhe të hapet Regjistri për Fermerët e Mëdhenj me rimbursim nga shteti.

**Statusi:** Është bashkëpunuar me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

**Rekomandim Nr. 5:**

Nga ana e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit dhe specialistëve përgjegjës që kanë krijuar këtë situatë ndërmjet kësaj drejtorie dhe qirramarrësit "DURO" sh.p.k, të merren menjëherë kontakte me qiramarrësin për arkëtimin e detyrimit të prapambetur 57.600 lekë dhe të bllokohet aktiviteti i qiramarrësit deri në lidhjen e një kontrate të re që nga data 30.03.2023 e në vazhdim sipas percaktimit ligjor të V.K.M. Nr.1060 datë.22.12.2010 dhe përcaktimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak që përcakton për zbatim këtë vendim.

**Statusi:** Subjekti debitor "Duro" Sh.p.k ka njoftuar se ka shlyer detyrimet.

**Rekomandim Nr. 6:**

Për shumën gjithësej të debitorëve prej 7.216.361 lekë, nga ana e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit dhe sektorëve përgjegjës për ndjekjen e këtyre debitorëve, të merren masa për njoftimin e tyre dhe arkëtimin e detyrimit të paarkëtuar në kohë si më sipër.

**Statusi:** Një pjesë e debitorëve i kanë shlyer detyrimet përkatëse, ndërsa për pjesën tjetër po bëhet ndjekja gjyqësore.

**Rekomandim Nr. 7**

Nga ana e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit dhe specialistëve në njësitë administrative, të ngrihet një komision për evidentimin e këtyre ngastrave të zaptuara dhe lirimin e Fondit Kullosor. Të hartohet një plan masash nga ana e drejtorisë dhe të hapet një regjistër per këto ngastra.

**Statusi:** Nuk ka pasur zaptime sipas kontrolleve të kryera.

**Rekomandim Nr. 8**

Nga ana e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit dhe sektorëve përkatës të përpilohet njoftim për detyrimet për të gjithë pronarët privatë sipas regjistrit që disponojnë për këto prona me detyrimin e prapambetur dhe atë aktual. Për pronarët që çdo vit kalendarik lidhin kontrata për shitjen pyjeve dhe kullotave me fermerët dhe që rezultojnë debitorë ndaj Bashkise Kolonjë të bëhet bllokimi nga ana e drejtorisë deri në arkëtimin vjetor të tyre.

**Statusi:** Po bashkëpunohet me Drejtorinë e Taksave për arkëtimin e detyrimeve në mënyrë të vazhdueshme.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna rezulton se:

Në auditimin e mëparshëm, sikurse del nga Raporti Përfundimtar Nr.1501/1 Prot., datë 27.03.2024, janë lënë për zbatim 8 rekomandime, të pranuara nga Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, të cilat janë përmbushur në vijimësi.

36. ***Opinion i përgjithshëm:***

*Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur dhe statusit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të vitit 2023 për Drejtorinë e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, rezulton një nivel vijues i reagimit ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna. Më konkretisht, 8 rekomandimet e dhëna, janë përmbushur, por në mënyrë vijuese. Situata e konstatuar nga auditimi tregon se Njësia e audituar ka reaguar në vijimësi për marrjen e masave për përmbushjen e rekomandimeve të lëna. Gjithashtu, është evidentuar shkelje e praktikave standarde, siç është rasti i mosrespektimit të formatit të miratuar për Planin e Veprimit, i cili është komunikuar në mënyrë zyrtare me Shkresën Nr. 3478 Prot., datë 17.07.2024.*

Raporti Përfundimtar i Auditimit hartohet në 4 (katër) kopje.

**Grupi i Auditimit**

**Laura Skënderas** **Arnold Fetallari**

ANEKSI NR. 1

# PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE

| Nr. | REKOMANDIMI | NIVELI I RISKUT |
|---|---|---|
| 1. | Të dorëzohen dëshmitë për njohjen e gjuhës së huaj nga ana e punonjësve Petro Kristo, Fatjon Kasko, Aurel Ramollari, Edrion Ajazi, Rushan Nazarko, Islam Liço, Eno Butka, Suljot Orhanasi dhe Ervin Çuka. | I ulët. |
| 2. | Të dorëzohen Vërtetimet e Njësimit me Origjinalin për diplomat dhe listat e notave brenda një afati të përcaktuar. | I lartë. |
| 3. | Kërkohet urgjentisht nga struktura përkatëse dorëzimi i të gjithë dokumentacionit që lidhet me procedurën e ngritjes në detyrë për punonjësin Petro Kristo në mënyrë që dosja të jetë e plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore. | I lartë. |
| 4. | Të njoftohen punonjësit përkatës që të dorëzojnë fotokopjen e dokumentit të identitetit brenda një afati të përcaktuar, në mënyrë që të plotësohen dosjet dhe të sigurohet përputhshmëri me kërkesat administrative dhe ligjore. | I mesëm. |
| 5. | Të kërkohet nga punonjësi Rushan Nazarko që të dorëzojë Jetëshkrimin në formatin Europass, në mënyrë që të plotësohet dokumentacioni dhe të garantohet përputhshmëria me standardet institucionale të administrimit të personelit. | I mesëm. |
| 6. | Të njoftohen punonjësit Islam Liço dhe Eno Butka që të dorëzojnë Certifikatën Personale dhe Familjare për të plotësuar dosjet dhe për të garantuar përputhshmërinë me rregulloret institucionale. | I mesëm. |
| 7. | Të ndërmerret një proces verifikimi për të identifikuar të gjitha dosjet ku mungojnë këto dokumente dhe të plotësohen me Fletën Prezantuese dhe Inventarin përkatës, duke ndjekur një model të unifikuar për të gjitha dosjet e personelit. | I ulët. |
| 8. | Të plotësohen dosjet e personelit me Kontratat Individuale të Punës për pozicionet që rregullohen nga Kodi i Punës. | I lartë. |
| 9. | Të hartohen dhe përditësohen përshkrimet e detajuara të punës për të gjitha pozicionet në përputhje me standardet institucionale, dhe të | I lartë. |

| | | |
|---|---|---|
| | integrohen në dosjet e personelit për të siguruar qartësi dhe transparencë në funksionet dhe përgjegjësitë e çdo punonjësi | |
| **10.** | Të plotësohen dosjet e personelit me vlerësimet e rezultateve 6 mujore dhe vjetore për të gjithë punonjësit dhe duke plotësuar dosjet ekzistuese me mungesat e identifikuara. | I lartë. |
| **11.** | Të ndërmerret një proces rishikimi dhe harmonizimi i Rregullores së Brendshme në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse, për të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e çdo pozicioni, në funksion të një ndarje të saktë të punës dhe rritjes së efikasitetit. | I lartë |
| **12.** | Të hartohet dhe miratohet në mënyrë urgjente Rregullorja e Brendshme e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, sipas parimeve të ndarjes së qartë të funksioneve dhe përgjegjësive dhe të sigurohet arkivimi i saj në dosjet zyrtare dhe publikimi në përputhje me rregullat e transparencës. | I lartë. |
| **13.** | Të ngrihet komision për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike të Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, në zbatim të paragrafëve 107, 108 dhe 109 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" (*i ndryshuar*) i Ministrisë së Financave si dhe të përditësohen regjistrat kontabël pas vlerësimit dhe të reflektohet situata reale e aseteve. | I mesëm. |
| **14.** | Drejtoria duhet të hartojë dhe të miratojë në mënyrë të rregullt Planet Mujore të Punës, duke siguruar ruajtjen dhe dokumentimin e tyre për çdo periudhë. | I lartë. |
| **15.** | Drejtoria duhet të hartojë dhe zbatojë një procedurë të qartë për realizimin dhe dokumentimin e analizave mujore dhe raporteve periodike të punës, duke siguruar ruajtjen e tyre dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme përmes strukturave përkatëse të kontrollit të brendshëm. | I lartë. |
| **16.** | Drejtoria të hartojë, miratojë dhe zbatojë një Plan të detajuar për mbrojtjen e biodiversitetit, në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare, duke përfshirë masa konkrete, afate kohore dhe mekanizma monitorimi. | I lartë. |
| **17.** | Drejtoria të hartojë dhe miratojë në mënyrë periodike Plan-Projektet Vjetore për operacionet dhe masat teknike në fondin pyjor dhe kullosor, duke përfshirë një vlerësim të qartë të nevojave financiare dhe duke i integruar ato në procesin e planifikimit buxhetor të institucionit. | I lartë. |
| **18.** | Rekomandohet që institucioni të ndërmarrë menjëherë hapat për hartimin | I lartë. |

| | | |
|---|---|---|
| | dhe miratimin e Planeve të Mbarështimit për pyjet dhe kullotat, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke bashkëpunuar me specialistë të fushës dhe duke siguruar fondet e nevojshme për zbatimin e tyre. | |
| **19.** | Drejtoria të hartojë dhe të miratojë planet operacionale vjetore për aktivitetet në pyje dhe kullota, duke përfshirë objektiva të qarta, masa teknike, afate kohore dhe vlerësim financiar. Këto plane duhet të shërbejnë si bazë për zbatimin, monitorimin dhe kontrollin efektiv të aktiviteteve në terren. | I mesëm. |
| **20.** | Drejtoria dhe të miratojë një Strategji dhe Plan Veprimi për menaxhimin e kullotave dhe livadheve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet mjedisore. Ky dokument duhet të përfshijë objektiva të matëshme, masa konkrete, burime financiare dhe mekanizma monitorimi për zbatimin në terren. | I lartë. |
| **21.** | Drejtoria të hartojë, miratojë dhe zbatojë një Plan të detajuar të Masave për mbrojtjen e fondit kullosor nga zjarri, duke përfshirë masa parandaluese, koordinim me aktorët relevantë dhe mekanizma monitorimi efektiv. | I lartë. |
| **22.** | Rekomandohet që Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit të marrë masa për garantimin e respektimit të kuadrit ligjor në fushën e administrimit dhe mbrojtjes së pyjeve, duke siguruar dokumentimin dhe arkivimin e plotë të të gjitha inspektimeve pyjore, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.57/2020 "Për Pyjet" (*i ndryshuar*) si dhe akteve nënligjore në fuqi. | I lartë. |
| **23.** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit të marrë masa për garantimin e respektimit të kuadrit ligjor në fushën e administrimit dhe mbrojtjes së pyjeve, duke siguruar dokumentimin dhe arkivimin e plotë të trajtimeve drusore dhe furnizimeve me dru zjarri, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.57/2020 "Për Pyjet" (*i ndryshuar*), Kreu V dhe akteve nënligjore në fuqi. | I lartë. |
| **24.** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit të sigurojë dokumentimin dhe arkivimin e plotë të masave të ndërmarra për monitorimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore, në përputhje me ligjin dhe akteve nënligjore në fuqi. | I lartë. |
| **25.** | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit të sigurojë dokumentimin dhe arkivimin e plotë të masave të ndërmarra për mbikëqyrjen e punës dhe zbatimin e masave për përmirësimin e zonave të gërryera, si dhe për | I mesëm. |

| | | |
|---|---|---|
| | parandalimin dhe menaxhimin e erozionit, rrëshkitjeve dhe ortekëve, në përputhje me ligji dhe aktet nënligjore në fuqi. | |
| **26.** | Drejtoria të sigurojë dokumentimin dhe arkivimin e plotë të masave të ndërmarra për trajnimin dhe mbështetjen e pronarëve/përdoruesve të fondit pyjor dhe për zhvillimin e kërkimeve shkencore, në përputhje me ligjin dhe akteve nënligjore në fuqi. | I mesëm. |
| **27.** | Të hartohet menjëherë studimi përkatës mbi sipërfaqet pyjore/kullosore për përdorim, duke respektuar kriteret ligjore dhe procedurat e miratimit, dhe të sigurohet dokumentacioni i plotë për çdo vendim të Kryetarit të Bashkisë lidhur me përdorimin e këtyre sipërfaqeve. | I lartë. |
| **28.** | Të hartohen menjëherë Raportet Tekniko-Ekonomike në përputhje me Shtojcën Nr.1 të Udhëzimit Nr.1, duke siguruar që të gjitha kërkesat për përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor publik të dokumentohen dhe të shqyrtohen sipas procedurave ligjore. | I lartë. |
| **29.** | Të plotësohen Formularët Nr. 1–5 sipas formatit dhe udhëzimeve të Udhëzimit Nr. 1, duke siguruar që çdo kërkesë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor publik të dokumentohet dhe shqyrtohet në përputhje me ligjin. | I lartë. |
| **30.** | Të sigurohet dokumentacioni i plotë mbi çdo hap të procesit të vlerësimit dhe shpalljes së ofertave fituese, duke respektuar procedurat e Udhëzimit Nr. 1 dhe duke ruajtur transparencën dhe llogaridhënien administrative. | I lartë. |
| **31.** | Të plotësohen menjëherë dosjet e kontratave të munguara dhe të sigurohet që të gjitha kontratat e ardhshme të ruhen dhe arkivohen sipas procedurave të brendshme dhe legjislacionit në fuqi. | I lartë. |
| **32.** | Të gjendet dhe të arkivohet vendimi Nr. 32 dhe të sigurohet që të gjitha vendimet për kontratat e ardhshme të ruhen dhe dokumentohen sipas procedurave të brendshme dhe legjislacionit në fuqi. | I lartë. |
| **33.** | Të plotësohen kontratat e munguara për vendimet Nr. 37 dhe Nr. 49 dhe të sigurohet që të gjitha kontratat e ardhshme të ruhen dhe dokumentohen sipas procedurave të brendshme dhe legjislacionit në fuqi. | I lartë. |
| **34.** | Të hartohen dhe të ruhen Proces-Verbalet për marrjen në dorëzim të të gjitha sipërfaqeve sipas kontratave të qirasë dhe të sigurohet që ky dokumentim të bëhet për çdo kontratë të ardhshme. | I lartë. |
| **35.** | Të sigurohen menjëherë evidencat e kontratave të lidhura në vitin 2025 dhe të vendosen procedura të qarta për regjistrimin dhe ruajtjen e të gjitha | I lartë. |

| | | |
|---|---|---|
| | kontratave të ardhshme në përputhje me legjislacionin dhe procedurat e brendshme. | |
| 36. | Të sigurohet regjistrimi dhe ruajtja e të gjitha kërkesave të subjekteve për marrjen e kullotave me qira dhe të zbatohet procedura e plotë e vlerësimit dhe përzgjedhjes së subjektit fitues sipas Udhëzimit Nr. 1, datë 9.6.2016. | I lartë. |
| 37. | Të sigurohet dokumentacioni i plotë shoqërues për çdo kërkesë për marrjen me qira të kullotave, duke përfshirë certifikatën veterinare, vërtetimin e njësisë administrative dhe listën e objekteve për ndihmë të kullotjes, dhe të zbatohet procedura e plotë e kontrollit sipas Udhëzimit Nr. 1, datë 9.6.2016. | I lartë. |
| 38. | Të respektohen afatet ligjore për shqyrtimin e kërkesave dhe lidhjen e kontratave dhe të vendosen mekanizma për monitorim të brendshëm që sigurojnë zbatimin e afateve në të gjitha rastet e ardhshme. | I lartë. |
| 39. | Të vendosen procedura të qarta dhe të zbatohet monitorimi i rregullt i kullotjeve nga qiradhënësi, përfshirë realizimin e sondazheve periodike gjatë gjithë periudhës së qiradhënies, për të garantuar përdorim të ligjshëm dhe të qëndrueshëm të kullotave. | I ulët. |
| 40. | Të hartohen dhe të ruhen Proces-Verbalet për çdo mbledhje të strukturës përkatëse mbi shqyrtimin e kërkesave dhe të sigurohet që ky dokumentim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha mbledhjet e ardhshme. | I lartë. |
| 41. | Të dorëzohen menjëherë evidencat e përdorimit të fondeve pyjore dhe kullosore dhe të vendosen procedura të rrepta për raportim mujor në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore. | I mesëm. |
| 42. | Të kërkohet zbatimi i detyrimit kontraktual nga subjektet qiramarrëse për informimin me shkrim mbi ecurinë e veprimtarisë dhe problematikat e hasura, si dhe të vendosen mekanizma monitorimi për ndjekjen e rregullt të këtyre raportimeve. | I mesëm. |
| 43. | Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për të organizuar dhe zbatuar në praktikë detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për gjuetinë. Po ashtu, duhet të hartohet dhe zbatohet një program i rregullt i monitorimit të gjuetisë, të bëhet mbledhja dhe analizimi i të dhënave mbi treguesit biologjikë dhe ekologjikë si dhe raportimi periodik në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi. | I lartë. |
| 44. | Njësia e audituar duhet të marrë masa të menjëhershme për ngritjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit të Fondit Pyjor në nivel | I lartë. |

| | | |
|---|---|---|
| | vendor, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke siguruar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mbi fondin pyjor publik dhe privat, përfshirë evidencat mbi sëmundjet, dëmtuesit dhe zjarret. | |

**Grupi i Auditimit**

**Laura Skënderas** **Arnold Fetallari**

**ANEKSI NR. 2**

# OBSERVACIONET

Subjekti i audituar, me shkresën Nr. 2903/1 Prot., datë 22.09.2025 ka paraqitur Observacionet mbi gjetjet e konstatuara dhe të pasqyruara në Projekt-Raport. Observacionet janë pranuar nga ana e Njësisë së Auditit të Brendshëm me konkluzionet e paraqitura në këtë Aneks. Nga ana e njësisë së audituar nuk u kërkua takim ballafaques me Titullarin e Institucionit.

**Observacion mbi vlerësimin e Sistemit të Planifikimit dhe Menaxhimit të Burimeve:**

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 01 | Gjuha e huaj është lëndë që është bërë në shkollë. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Në dosjen e personelit mungon dëshmia e gjuhës së huaj për punonjësit e përmendur në Gjetjen Nr.1. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Në Vendimi Nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qëndror të Personelit", në Lidhjen Nr. 1, pika 3, shkronja "e", parashikohet detyrimi që për gjihën e huaj të deklaruar të paraqitet dëshmia përkatëse e mbrojtjes. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I ulët. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 02, 03, 04, 05, 06, 07, 08, 09 dhe 10. | Dosjet e personelit menaxhohen nga Burimet Njerëzore, për mungesat e dokumentave të përmendura nga ju do të plotësohen. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Observacioni i sipërcituar nuk përbën Observacion per se, pasi pranon gjetjen dhe rekomandimin e lënë nga Njësia e Auditit të Brendshëm. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetjet dhe Rekomandimet qëndrojnë. |
| Rishikim i nivelit të riskut | Varion sipas gjetjes. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 11 | Detyrat e punonjësve janë të ndara, struktura është e ndarë:<br>1 Drejtor, 1 Përgjegjës Drejtorie, 1 Specialist Menaxhimi, 1 Specialist Kadastre dhe Kullotash, janë 5 inspektorë terreni të ndarë në zona të ndryshme. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Gjetja e paraqitur nga Njësia e Auditit të Brendshëm, nuk fokusohet mbi strukturën e brendshme të Drejtorisë, por mbi darjen e |

| | |
|---|---|
| | detyrave funksionale ku ka paqartësi dhe përplasje kompetencash. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 12 | Rregullorja është dhe e miratuar nga Kryetari i Bashkisë, rregullore për "Organizimin, Funksionimin, Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Kolonjë". |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Nga Observacioni i paraqitur rezulton se ka një ngatërresë mes dy koncepteve dhe akteve juridike, ku përkatësisht Akti i cituar në Observacion përbën dokument themelor të Institucionit, ndërsa Akti i cituar në gjetjen Nr. 12 përbën dokument të brendshëm të Drejtorisë. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 13 | Komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të konstatuara si të tilla nga Komisioni i Inventarizimit nuk ngrihet nga Drejtoria jonë. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Nga inventarizimi i kryer, është evidentuar ekzistenca e aktiveve jashtë përdorimit, por për këto nuk është ngritur komisioni përkatës për vlerësimin dhe nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore. Drejtoria, në momentin e ngritjes së Komisionit përkatës ka detyrim ligjor të bashkëpunojë me qëllim nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I mesëm. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 14 | Planet e punës janë 15 ditore dhe do ju vihen në dispozicion. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Në dokumentacionin e dorëzuar pranë Njësisë së Auditit të Brendshëm nuk ka pasur plane pune, mujore apo 15 ditore. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. Pritet dërgimi i Planeve 15 ditore. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 15 | Evidenca mujore nuk ka, Janë raportime mujore që Drejtuesi i Institucionit i ka bërë në rrugë elektronike. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Sipas kuadrit rregullator në fuqi, çdo drejtori ka detyrimin të raportojë periodikisht, përkatësisht mbi veprimtarinë e saj për periudha 1 mujore, 4 mujore, 8 mujore, vjetore, raporte këto të cilat mungojnë në dokumentacionin e dorëzuar. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 16 | Plan mbi mbrojtjen e biodiversitetit nuk ka, për mbrojtjen Drejtoria jonë mbështetet në Ligjin 57/2020 "Për Pyjet", neni 17 "Përgjegjësitë e strukturave vendore përgjegjëse për pyjet". |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Kolonjë, në Kreun që rregullon detyrat dhe funksionet e Drejtorisë së Pyjeve, Parqev e dhe Rekreacionit, parashikohet detyrimi për hartimin e Planit për mbrojten e biodiversitetit. Mungesa e këtij plani përbën si shkelje ligjore ashtu edhe shkelje të Rregullores së Institucionit. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 17 | Janë të pasqyruara në PBA. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Gjetja e konstatuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm dhe Observacioni i paraqitur nga subjekti i audituar nuk janë në koherencë midis tyre. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 18 | Planet e Mbarështrimit janë dy plane që janë bërë në vitin 2023 dhe 2024 dhe në këto momente po hartohet dhe plani i tretë. Për realizimin e planeve kërkohet buxhet i madh dhe kjo nuk varet nga ne (Drejtoria e Financës), planifikimi në PBA çdo vit të bëhet |

| | |
|---|---|
| | një Plan. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Programi Buxhetor Afatmesëm i Institucionit hartohet duke marrë në konsideratë nevojat financiare për çdo Drejtori si dhe mundësitë objektive financiare të realizimit të këtyre nevojave. Detyrimi për hartimin e Planeve të Mbarështimit buron nga Ligji, nërsa realizimi i këtij të fundit varet nga faktorë financiarë dhe në asnjë moment, hartimi i tij nuk pengohet nga aftësia ekonomike e Institucionit. Për më tepër Planet e Mbarështimit për vitet 2023 dhe 2024 nuk janë dorëzuar pranë Njësisë së Auditit të Brendshëm. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. Pritet dorëzimi i Planit për vitin 2025. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 19 | Planet operacionale hartohen mbi bazën e Planeve të Mbarështimit që janë në fuqi ku janë planifikuar ndërhyrje në fondin pyjor dhe kullosor. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Hartimi i Planeve Operacionale është detyrim që buron nga Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Kolonjë. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I mesëm. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 20 | Strategjia dhe Plani i Veprimit për kullotat dhe livadhet mbështetet në Udhëzimin Nr. 2, datë 20.07.2016 "Kritetet teknike të klasifikimit të kullotave dhe livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari". |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Baza ligjore nga buron detyrimi i hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për kullotat dhe livadhet nuk përbën Observacion. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 21 | Plani i masave kundra zjarreve për fondin kullosor dhe atë pyjor është dhe do ju vihet në dispozicion. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Pritet dorëzimi i Planit të Masave. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja është pranuar. |

| | |
|---|---|
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

**Observacion mbi vlerësimin e Sistemit të Menaxhimit të Pyjeve:**

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 22 | Evidencat janë dhe do ju vihen në dispozicion. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se mungojnë evidencat përkatëse mbi inspektimin pyjor. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. Pritet dorëzimi i dokumentacionit. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 23 | Evidencat janë dhe do ju vihen në dispozicion. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se mungojnë evidencat përkatëse mbi trajtimin drusor dhe furnizimin me dru zjarri. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. Pritet dorëzimi i dokumentacionit. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr.24 | Evidenca të tilla nuk ka, referuar nga ana juaj Ligjit 57/2020 "Për Pyjet", neni 17, pika 1, gërma g, tregon "kontrollon dhe realizon proceset inspektuese për zbaimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për pyjet, duke përfshirë veprimtaritë që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar nga subjektet private e publike, juridike e fizike, mbikëqyr zbatimin e kushteve të lejeve, lishencave e detyrimeve kontraktuale nga ana e tyre, si dhe propozon te institucioni përgjegjës pezullimin dhe shfuqizimin e tyre" dhe jo monitorimin e mirëmbajtjes dhe strukturës. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Nga dokumentacioni i dorëzuar mungon çdo lloj evidence që të provojë se nga ana e subjektit të audituar janë marrë masa në zbatim të parashikimeve ligjore. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 25 | Të gjitha evidencat do ju vihen në dispozicion, por lidhur me bazën ligjore referuar ligjit 57/ 2020 "Për Pyjet" neni 17, pika 1, gërma dh |

| | |
|---|---|
| | tregon "drejton dhe mbikëqyr punën për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e erozionit, të rrëshqitjeve dhe oretkëve brenda territorit të bashkisë, si dhe luftën ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Mungojnë evidencat mbi masat e marra për zbatimin e detyrimeve ligjore. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I mesëm. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 26 | Do ju vihen në dispozicion. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Pritet dorëzimi i dokumentacionit. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I mesëm. |

**Observacion mbi vlerësimin e Sistemit të Menaxhimit të Kullotave:**

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 27 | Lista me të gjitha sipërfaqet kullosore është miratuar në Këshillin Bashkiak me Vendim Nr.21, datë 20.02.2025. Do ju vihet në dispozicion. Baza ligjore nuk është udhëzimi Nr.1, datë 9.6.2016, por Udhëzimi Nr.2, datë 20.07.2016 "Kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve për procedurat për dhënien etyre për kullotje e kositje bari". |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Mungon dokumentacioni në dosjen e dorëzuar. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. Pritet vënia në dispozicion e dokumentacionit. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 28 | Raportet teknike hartohen kur sipërfaqet kullosore apo pyjore jepen në përdorim për veprimtari ekonomike dhe jo për kullotje e kositje bari. Vendimi 559, datë 29.07.2022. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Për pjesën e fondit pyjor e kullosor të dhënë në përdorim, mungojnë evidencat për mbajtjen e raporteve teknike. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 29 | Formularët 1,2,3,4,5 janë pjesë e Raportit |

| | |
|---|---|
| | Teknik, shpjeguar tek gjetja 28. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Për fondin pyjor dhe kullosor të dhënë në përdorim, mungojnë evidencat me formularët përkatës. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 30 | Kjo është proçedurë ankandi, kur sipërfaqet e fondit pyjor/kullosor jepen për veprimtari ekonomike, këto i vendos komisioni i vlerësimit të ofertave. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Mungon dokumentacioni që provon ndjekjen e procedurës së rregullt ligjore. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 31 | Vendimi Nr. 32 që i korrespodon kontratës me nr. 32 është anulluar pasi Fermeri nuk ka pranuar vendimin e komisjonit për parcelat e dhëna, dhe ka paraqitur një shkresë. Kontrata nr 37 nuk është bërë pasi fermeri ka bërë pagesën me vonesë, po ashtu kontrata 49 pasi pagesa është bërë me vonesë. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Nuk janë dorëzuar evidencat përkatëse me arsyetimin për mungesën e këtyre kontratave. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Mungojnë evidencat mbi moslidhjen/anulimin e këtyre kontratave si dhe arsyetimin përkatës. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I mesëm. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 32 | Vendimi nr 32 është anulluar pasi fermeri nuk ka pranuar vendimin e komisionit dhe ka depozituar shkresë pranë drejtorisë tonë. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Nuk janë dorëzuar evidencat përkatëse me arsyetimin për mungesën e këtij vendimi. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Mungojnë evidencat shpjeguese për mungesën e Vendimit Nr. 32. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I mesëm. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 33 | Mungesa për arsye se pagesa me vonesë. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Observacioni i paraqitur nuk shpjegon apo justifikon gjetjen. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 34 | Udhëzimi nr 1 është për dhënien në përdorim për veprimtari ekonomike. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Udhëzimi Nr. 1 parashikon detyrimin që, në momentin e dorëzimit të sipërfaqes sipas kontratës respektive, të mbahet Proces-Verbali përkatës për marrjen në dorëzim të saj. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 35 | Evidencat për 2025 në proçes. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Kontratat e lidhura nga Janari 2025 deri në Maj 2025 janë objekt i këtij angazhim-auditimi dhe duhet të ishin dorëzuar rregullisht për qëllime auditimi. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. Pritet dorëzimi i dokumentacionit. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 36 | Do ju vihen ne dispozicion. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Observacioni i paraqitur pranon gjetjen. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. Pritet dorëzimi i dokumentacionit. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 37 | Dokumentacioni është i bashkëlidhur me kërkesat e fermerit, do ju vihen në dispozicion. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Observacioni i paraqitur pranon gjetjen. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. Pritet dorëzimi i dokumentacionit. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 38 | Këto problematika ndodhin për arsye se një pjesë e fermerëve i sjellin me vonesë kërkesat dhe për të mos i lënë pa kullotë, ne marrim vendime që i kalojnë afatet. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Observacioni pranon shkeljen e afateve ligjore. Mungesa e informacionit dhe përgjegjshmërisë së fermerëve mbi afatet për dorëzimin e kërkesave, nuk nënkupton divijim apo |

| | |
|---|---|
| | mosrespektim të afatit ligjor. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 39 | Gjat periudhës së marrjes së kontratës janë kontrolluar fermerët dhe nuk ka pasur raste ku në një parcelë të ketë më shumë bagëti sesa është e lejueshme. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Kjo lloj veprimtarie nuk ka qënë e dokumentuar, pavarësisht se mund të jetë realizuar. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I ulët. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 40 | Do ju vihet në dispozicion. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Observacioni i paraqitur pranon gjetjen. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. Pritet dorëzimi i dokumentacionit. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 41 | Evidencat do ju vihen në dispozicion. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Observacioni i paraqitur pranon gjetjen. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. Pritet dorëzimi i dokumentacionit. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I mesëm. |

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 42 | Udhëzimi nr 1, datë 09.06.2016 është për dhënien në përdorim për veprimtari ekonomike me proçedurë ankandi dhe Udhëzimi nr 2 datë 20.07.2016 është "kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe proçedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari". |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Observacioni i paraqitur nuk është koherent me gjetjen e paraqitur nga Njësia e Auditit të Brendshëm. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I mesëm. |

**Observacion mbi vlerësimin e Sistemit të Gjuetisë:**

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 43 | Gjuetia. Ligji i memorandumit për gjuetine 61/2016 përjashton nga përgjegjësia për ndjekjen e gjuetis. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Observacioni i paraqitur është inkoherent dhe baza ligjore e sipërcituar parashikon masat dhe veprimet e ndërmarra në rastet kur është shkelur Memorandumi i Gjuetisë. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

**Observacion mbi vlerësimin e Sistemit të Menaxhimit Kadastral:**

| | |
|---|---|
| Observacioni i Gjetjes Nr. 44 | Sistemi i Menaxhimit Kadastral, pas transferimit në Bashki të pyjeve dhe kullotave me Vendim nr 398 datë 13.05.2020, sistemi i menaxhimit kadastral është proçes që zgjat deri në përfundimin e hartimit të Planeve të Mbarështrimit pasi këta plane japin specifikime mbi gjendjen e pyjeve, llojet, përbërjen. |
| Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen | Mungojnë evidencat përkatëse. |
| Rishikim i statusit të gjetjes | Gjetja qëndron. |
| Rishikim i nivelit të riskut | I lartë. |

**Grupi i Auditimit**

**Laura Skënderas**

**Arnold Fetallari**